- (1) Глоба во износ од 1.500 до 2.500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на правно лице - давател на поштенски услуги, ако:
- не дава на располагање информации и финансиски податоци на Агенцијата заради извршување на нејзините надлежности (член 25 став (1)),
 - не доставува податоци за вкупниот приход (член 35 став (1)),
 - затвора поштенската единица без добиена согласност (член 36 став (6)),
 - не склучува договор за пристап со даватели на поштенски услуги (член 47 став (9)),
 - при утврдување на цена и условите за пристап до поштенската мрежа прави разлика меѓу различните даватели на поштенски услуги (член 47 став (14)),
 - не предвиди цени и општи услови од членот 48 став (2) на овој закон,
 - формира цени за големите корисници спротивни на членот 50 став (9) од овој закон,
 - користи неважечки поштенски марки спротивно на членот 53 став (1) од овој закон и
 - го попречува вршењето на надзорот на овластеното лице (член 77 став (1)).
- (2) Глоба во износ од 300 до 500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече и на одговорното лице во правното лице за прекршокот од ставот (1) на овој член.

Член 82

- (1) Глоба во износ од 1.000 до 1.500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на правно лице - давател на поштенски услуги, ако:
- не постави поштенски сандачиња (член 56 став (1)),
 - не ги одржува поштенските сандачиња во согласност со членот 56 став (2) од овој закон и
 - не прима или не одговори на рекламации од корисници на поштенски услуги согласно со членот 63 став (6) од овој закон.
- (2) Глоба во износ од 100 до 300 евра во денарска противвредност ќе му се изрече и на одговорното лице во правното лице за прекршокот од ставот (1) на овој член.

Член 83

- (1) Глоба во износ од 500 до 1.000 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на физичко лице - давател на поштенски услуги, ако:
- не дава на располагање информации и финансиски податоци на Агенцијата заради извршување на нејзините надлежности (член 25 став (1)),
 - не доставува податоци за вкупниот приход (член 35 став (1)),
 - обезбедува поштенски услуги без општо овластување (член 38 став (2)),
 - обезбедува поштенски услуги кои не се наведени во општото овластување (член 41 став (2)),
 - обезбедува пратки за кореспонденција и услуги на директна пошта по цени пониски од пропишаното ограничување (член 41 ставови (3), (4) и (5)),
 - пренесува права и обврски на друго правно лице (член 43),
 - обезбедува поштенски услуги и по укинување на општо овластување (член 45 став (7)),
 - обезбедува поштенска услуга и по престанок на важноста на општото овластување (член 46 став (5)),
 - не предвиди цени и општи услови од членот 48 став (2) на овој закон,
 - не води посебно сметководство согласно со членот 51 став (1) од овој закон,
 - достави поштенска пратка спротивно од членот 54 став (1) на овој закон,
 - не ја штити тајноста на поштенските пратки при обезбедувањето на поштенските услуги од членот 58 на овој закон,
 - врши пренос на поштенски пратки чиј пренос е забранет (член 60),
 - не прима и не одговори на рекламации од корисници на поштенски услуги согласно со членот 63 став (6) од овој закон,
 - го попречува вршењето на надзорот на овластеното лице согласно со членот 77 став (1) од овој закон,
 - не овозможи влегување на овластеното лице согласно со членот 77 ставови (3) алинеја 1 и (4) алинеја 1 од овој закон,
 - не стави на увид и на барање на овластеното лице не ги даде сите потребни информации, податоци и документација согласно со членот 77 ставови (3) алинеја 2 и (4) алинеја 2 од овој закон и
 - не постапи по решение и не ги отстрани утврдените неправилности во утврдениот рок (член 78 став (3)).
- (2) За прекршоците од ставот (1) на овој член на физичко лице, покрај глобата, може да му се изрече и забрана на вршење професија, дејност или должност во траење од една до три години.

Член 84

- Глоба во износ од 300 до 500 евра во денарска противвредност ќе му се изрече за прекршок на физичко лице - давател на поштенски услуги, ако:
- не прима и не одговори на рекламации од корисници на поштенски услуги согласно со членот 63 став (6) од овој закон.

Член 85 Постапка за едукација

(1) Доколку при вршењето на надзорот овластеното лице утврди дека е сторена неправилност од членовите 56 ставови (1) и (2) и 63 став (6) на овој закон, е должно да состави записник во кој ќе ја утврди сторената неправилност со укажување за отстранување на утврдената неправилност во определен рок и со истовремено врачување на покана за спроведување на едукација на лицето или субјектот каде што е утврдена неправилноста при вршењето на надзорот.

(2) Формата и содржината на поканата за едукација, како и начинот на спроведување на едукацијата ги пропишува Комисијата на Агенцијата.

(3) Едукацијата ја организира и спроведува овластеното лице во рок не подолг од осум дена од денот на спроведувањето на надзорот.

(4) Едукацијата може да се спроведува за повеќе утврдени исти или истородни неправилности, за едно или повеќе лица.

(5) Доколку во закажаниот термин лицето над кое се спроведува едукација не се јави на едукацијата ќе се смета дека едукацијата е спроведена.

(6) Доколку лицето над кое се спроведува едукација се јави на закажаната едукација и истата ја заврши ќе се смета дека е едуциран по однос на утврдената неправилност.

(7) Доколку овластеното лице при спроведување на контролниот надзор утврди дека се отстранети утврдените неправилности од ставот (1) на овој член, со заклучок се запира постапката за надзор, а доколку утврди дека не се отстранети утврдените неправилности, овластеното лице е должно веднаш да го извести директорот на Агенцијата и да му ги достави сите списи од надзорот заради поведување прекршочна постапка.

(8) Агенцијата води евиденција за спроведената едукација на начин пропишан од Комисијата на Агенцијата.

Член 86 Постапка за порамнување

(1) За прекршоците утврдени со овој закон пред поднесување барање за поведување на прекршочна постапка, овластеното лице е должно на сторителот на прекршокот да му предложи постапка за порамнување.

(2) Кога овластеното лице ќе го констатира прекршокот од ставот (1) на овој член составува записник во кој се забележуваат битните елементи на прекршокот, времето, местото и начинот на сторување на прекршокот, описот на дејствието на прекршокот и лицата затекнати на самото место. Записникот го потпишуваат овластеното лице и сторителот.

(3) Ако сторителот го признае прекршокот овластеното лице му издава платен налог заради наплата на глобата за прекршокот.

(4) Со потписот на платниот налог се смета дека сторителот на прекршокот се согласува да ја плати изречената глоба.

(5) Сторителот на прекршокот од ставот (1) на овој член е должен да ја плати глобата во рок од осум дена од денот на приемот на платниот налог на сметка на Буџетот на Република Македонија означена во платниот налог. Сторителот кој ќе ја плати глобата во рокот утврден во овој став ќе плати само половина од изречената глоба.

(6) Доколку сторителот на прекршокот одбие да се потпише на платниот налог овластеното лице евидентира дека лицето одбило да се потпише.

(7) Доколку сторителот на прекршокот не се согласи на постапка за порамнување или во утврдениот рок не ја плати глобата, овластеното лице е должно веднаш да го извести директорот на Агенцијата и да му ги достави сите списи од надзорот заради поведување прекршочна постапка.

(8) Агенцијата води евиденција за прекршочните постапки за порамнување.

XV. ПРЕОДНИ И ЗАВРШНИ ОДРЕДБИ

Член 87

Започнатите постапки до денот на влегувањето во сила на овој закон ќе продолжат пред Агенцијата согласно со Законот за поштенските услуги ("Службен весник на Република Македонија" број 9/2008).

Член 88

Претседателот и членовите на Комисијата како орган на Агенцијата и директорот на Агенцијата, именувани до денот на влегувањето во сила на овој закон, продолжуваат со работа до истекот на мандатот за кој се именувани.

Член 89

Статутот на Агенцијата ќе се усогласи со одредбите на овој закон во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

Член 90

(1) Постојниот давател на универзална услуга по влегувањето во сила на овој закон ќе продолжи да ја обезбедува универзалната услуга заедно со резервираната услуга врз основа на индивидуална дозвола издадена од Агенцијата во согласност со Законот за поштенските услуги ("Службен весник на Република Македонија" број 9/2008) се до истекот на рокот на важење на дозволата.

(2) Правните и физичките лица кои имаат добиено индивидуална и стандардна дозвола или одобрение за обезбедување на поштенски услуги ќе продолжат со нивното обезбедување на начин и под услови пропишани со овој закон.

(3) Заради спроведување на овој закон Агенцијата може да побара од лицата од ставот (2) на овој член дополнителни податоци доколку смета дека е потребно.

Член 91

(1) Подзаконските прописи чие донесување е предвидено со овој закон ќе се донесат во рок од шест месеци од денот на влегувањето во сила на овој закон.

(2) До донесувањето на прописите од ставот (1) на овој член ќе се применуваат постојните прописи.

Член 92

(1) Давателот на универзалната услуга со денот на влегувањето во сила на овој закон има ексклузивно право да обезбедува резервирани поштенски услуги до 31 декември 2014 година.

(2) По истекот на рокот од ставот (1) на овој член престануваат да важат одредбите од членот 41 ставови (3), (4) и (5), членот 80 став (1) алинеја 6 и членот 83 став (1) алинеја 5 на овој закон.

Член 93

Со денот на влегувањето во сила на овој закон престанува да важи Законот за поштенските услуги ("Службен весник на Република Македонија" број 9/2008).

Член 94

Овој закон влегува во сила наредниот ден од денот на објавувањето во "Службен весник на Република Македонија".

L I G J I PËR SHËRBIME POSTARE

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Lënda e Ligjit

Me këtë ligj rregullohen kushtet, mënyra dhe procedurat për sigurimin e shërbimeve postare në komunikacionin e brendshëm postar dhe ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e dhënësve dhe shfrytëzuesve të shërbimeve postare, përcaktohen pozita juridike, kompetencat, organizimi dhe puna e Agjencisë për Posta dhe rregullohen çështje tjera lidhur me veprimtarinë postare.

Neni 2 Zbatimi dhe qëllimet e Ligjit

(1) Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të gjithë dhënësit e shërbimeve postare në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar postar.

(2) Për procedurat që përcaktohen me këtë ligj zbatohen dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Qëllimet e këtij ligji janë:

- sigurimi i shërbimeve postare,
- sigurimi i shërbimit universal në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë,
- përcaktimi i mënyrës së financimit të shërbimit universal për sigurimin e tyre të përhershëm,
- përcaktimi i standardeve për kualitet të sigurimit të shërbimit universal dhe përcaktimi i sistemit për zbatimin e këtyre standardeve,
- mbrojtja e interesave të shfrytëzuesve të shërbimeve postare,
- mundësimi i konkurrencës në sferën e shërbimeve postare sipas kushteve objektive, transparente dhe jodiskriminuese, në mënyrë graduale dhe të kontrolluar me qëllim që të garantohet siguri i shërbimeve universale,
- zhvillimi i infrastrukturës postare në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë për sigurim me kualitativ të shërbimeve postare,
- formimi i çmimeve për shërbime postare mbi parme objektive, transparente dhe jodiskriminuese dhe
- funksionimi i shërbimeve postare në interes të Republikës së Maqedonisë.

Neni 3 Interesi publik

Sigurimi i shërbimit universal dhe emetimi i pullave postare dhe letrave postare me vlerë, si dhe përpunimi, mirëmbajtja, zhvillimi dhe puna në rrjetin postar dhe infrastrukturën shoqëruuese janë punë me interes publik.

Neni 4 Definicionet

Nocione të caktuara të përdorura në këtë ligj e kanë kuptimin si vijojnë:

- shërbim postar është shërbim i adresuar me adresë të plotë që duhet të bartet nga ana e dhënësit të shërbimeve postare. Në dërgesën postare bëjnë pjesë dërgesa për korrespondencë, dërgesa për persona të verbër, posta direkte, libra, katalogë, gazeta, magazina periodike dhe pako që përmbajnë mall me ose pa vlerë të shënuar,

- dërgesa për korrespondencë është komunikimi në formë të shkruar të çfarëdo qoftë mediumi fizik që duhet të bartet dhe dorëzohet në adresën e shënuar nga dërguesi në vetë dërgesën ose në mbështjellësen e saj, nga ana e dhënësit të shërbimeve postare. Libra, katalogë, gazeta, magazina periodike dhe pako nuk llogariten për dërgesa për korrespondencë,

- postë direkte është komunikimi që përbëhet vetëm nga materiali reklamues, marketingu ose propagandistik me porosi identike e cila i dërgohet numrit më të madh të personave dhe dorëzohet në adresën që e ka shënuar dërguesi në vetë porosinë ose në mbështjellësen e saj. Llogaritë, faturat dhe raportet financiare nuk llogariten për postë direkte. Komunikimi që përmban kombinim nga materiali reklamues dhe dërgesa tjera në të njëjtën mbështjellëse, nuk llogariten si postë direkte,

- pako është dërgesë postare me madhësi dhe peshë të caktuar e cila përmban mall me ose pa vlerë të shënuar,

- dërgesë me rekomandim është shërbimi me të cilin në mënyrë paushalle garantohet kundër rrezikut të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit të pakos, me të cilën dërguesit me kërkesë të tij, i sigurohet dëshmi për dorëzimin e dërgesës pranuesit,

- dërgesa me vlerë të shënuar është shërbimi me të cilin sigurohet dërgesa postare deri në vlerën që e ka shënuar dërguesi në rast të humbjes, vjedhjes ose dëmtimit të dërgesës,

- shërbime postare janë shërbimet që përfshijnë pranim, bartje, klasifikim dhe distribuim të dërgesave postare në komunikacionin e brendshëm dhe ndërkombëtar postar,

- shërbim universal është pakoja me shërbime të caktuara postare të cilat vazhdimisht sigurohen në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë, me kualitet të caktuar dhe çmime të arsyeshme për shfrytëzuesit e shërbimit,

- qasje në rrjetin postar është qasje në kapacitetet, mjetet, lokalet dhe/ose shërbimet të cilitdo dhënësi të shërbimeve postare në kushte të caktuara, për sigurimin e shërbimeve postare,

- shërbime postare të rezervuara janë pranimi, klasifikimi, bartja dhe distribuimi i dërgesave për korrespondencë në komunikacionin e brendshëm postar dhe për dërgesa që vijnë nga komunikacioni ndërkombëtar postar me peshë deri në 50 gramë. Në shërbim të rezervuar bën pjesë shërbimi i postës direkte, në kuadër të kufizimeve të njëjta për peshë,

- trup i pavarur rregullator është personi juridik me autorizime publike, që e kryen funksionin e rregullimit të tregut të shërbimeve postare,

- dhënës i shërbimeve postare është personi vendas, ose i huaj juridik ose fizik i cili siguron shërbime postare në pajtim me këtë ligj,

- dhënës i shërbimeve universale është dhënësi i shërbimeve postare i cili siguron shërbim universal në territorin e Republikës së Maqedonisë në pajtim me këtë ligj,

- leje individuale është akti të cilin ia lëshon Agjencia për Posta dhënësit të shërbimeve postare me të cilën përcaktohen të drejta dhe detyrime për sigurimin e shërbimit universal, e plotësuar me të drejtat dhe detyrimet nga autorizimi i përgjithshëm,

- autorizim i përgjithshëm është akti me të cilin Agjencia dhënësit të shërbimeve postare i jep të drejtë për sigurimin e shërbimeve postare në pajtim me notifikacionin e parashtruar,

- rrjet postar është organizim i sistemit dhe mjeteve që përdoren nga dhënësi i shërbimeve universale për:

- pranim të dërgesave postare nga dhënësi i shërbimeve universale nga pikat e qasjes në të gjithë territorin,
- manipulim dhe bartje të dërgesave postare nga pikat për qasje në qendrën distributive dhe
- distribuim në adresën e shënuar në dërgesë,

- pika për qasje janë të gjitha llojet e objekteve fizike të dhënësit të shërbimit universal, duke përfshirë edhe arkat postare të vendosura në vendet publike ose në lokalet e dhënësit të shërbimit universal, ku dërgesat postare mund të jepen nga shfrytëzuesit,

- shfrytëzues i shërbimeve postare është personi juridik dhe fizik i cili si dërgues ose pranues shfrytëzon shërbime postare,

- dërgues është personi juridik ose fizik i cili dërgon dërgesa postare,

- pranues është personi juridik ose fizik ku janë adresuar dërgesat postare,

- pranim i dërgesave postare është procedura e marrjes së dërgesave postare nga ana e dhënësit të shërbimeve postare,

- shpërndarja është proces i cili përbëhet nga klasifikimi në qendrën e shpërndarjes për dërgesë të dërgesave postare pranuesit,

- person i autorizuar për kryerjen e mbikëqyrjes është personi i punësuar në Agjencinë për Posta me autorizime të veçanta dhe përgjegjësi të përcaktuara me këtë dhe ligj tjetër që kryen mbikëqyrje dhe

- subjekt i mbikëqyrjes është personi juridik ose fizik i cili kryen shërbime postare për të cilin kryhet mbikëqyrja.

II. KOMPETENCA NË SFERËN E SHËRBIMEVE POSTARE

Neni 5

Organe kompetente

Për kryerjen e punëve nga sfera e shërbimeve postare të miratuara me këtë ligj, kompetente janë:

- organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shërbimeve postare (në tekstin e mëtutjeshëm: organi i administratës shtetërore) dhe

- Agjencia për Posta (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia).

Neni 6

Kompetencat e organit të administratës shtetërore

Organi i administratës shtetërore:

- e zbaton politikën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në sferën e shërbimeve postare,

- e përpilon rregullativën ligjore nga sfera e veprimtarisë postare në bashkëpunim me Agjencinë,

- e përpilon Strategjinë për zhvillim të shërbimeve postare dhe e dorëzon për miratim në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë,

- e promovon zhvillimin e konkurrencës dhe liberalizimin në sferën e shërbimeve postare,

- i koordinon dhe harmonizon punët nga sfera e shërbimeve postare,

- i zbaton dispozitat me fuqi ligjore për kryerjen e veprimtarisë nga sfera e shërbimeve postare në gjendje lufte dhe të jashtëzakonshme,

- bashkëpunon me organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e mbrojtjes dhe organin e administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e punëve të brendshme në lidhje me çështjen nga sfera e shërbimeve postare që i përket mbrojtjes dhe sigurisë,

- e përfaqëson Republikën e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare në sferën e shërbimeve postare dhe komunikacionit postar, negocion dhe nënshkruan marrëveshje bilaterale dhe ndërkombëtare në sferën e shërbimeve postare dhe komunikacionit postar në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe

- kryen edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 7

Trup i pavarur rregullator

(1) Trup i pavarur rregullator në sferën e shërbimeve postare është Agjencia.

(2) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është themelues i Agjencisë. Prona dhe mjetet për punë të Agjencisë janë në pronësi të Republikës së Maqedonisë, kurse i shfrytëzon dhe me to menaxhon Agjencia.

(3) Agjencia themelohet si e pavarur dhe si person joprofitabil juridik, që kryen autorizim publik të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Agjencia në punën e saj dhe gjatë miratimit të vendimeve në kuadër të autorizimeve të saj është e pavarur nga organet tjera shtetërore ose nga personi tjetër publik juridik ose shoqëri tregtare që kryen veprimtari nga sfera e shërbimeve postare dhe është e paanshme ndaj tyre.

(5) Puna e Agjencisë është publike.

(6) Agjencia e merr statusin e personit juridik me regjistrim në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë.

(7) Selia e Agjencisë është në Shkup.

(8) Me qëllim të realizimit të aktiviteteve të caktuara në kuadër të kompetencave të saj, Agjencia mund të angazhojë persona tjerë nga vendi dhe të huaj juridikë dhe fizikë, duke e pasur parasysh konfliktin e interesave.

Neni 8

Fushëveprimi i punës së Agjencisë

(1) Agjencia kryen punë të përcaktuara me këtë ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të këtij ligji, si dhe në bazë të Strategjisë për zhvillim të shërbimeve postare në Republikën e Maqedonisë, si dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nga sfera e shërbimeve postare që i ka lidhur ose të cilat i ka pranuar Republika e Maqedonisë.

(2) Agjencia siguron respektim të obligimeve që dalin nga Direktivat e Unionit Evropian dhe Aktet e Lidhjes Postare Botërore.

(3) Agjencia gjatë kryerjes së punëve nga fushëveprimi i saj siguron:

- kushte për sigurim të vazhdueshëm, të rregullt dhe pandërprerë të shërbimit universal,

- mundësim të qasjes së barabartë në shërbimin universal për shfrytëzuesit në lidhje me kualitetin, çmimin dhe cilësinë,

- nxitje të qasjes në rrjetin postar,

- promovim dhe mbrojtje të konkurrencës në sferën e shërbimeve postare dhe

- hapje të tregut me qëllim të krijimit të tregut unik të shërbimeve postare.

Neni 9

Kompetencat e Agjencisë

Për realizimin e punëve nga neni 8 i këtij ligji, Agjencia është kompetente që:

- të miratojë dhe të zbatojë akte nënligjore në bazë të këtij ligji,

- ta sigurojë mbrojtjen e shërbimeve universale,

- të sigurojë kushte për qasje të shfrytëzuesve në shërbimin universal,

- të zbatojë procedurë për përcaktimin e dhënësit të shërbimit universal,

- të miratojë vendim për përcaktimin e dhënësit të shërbimit universal,

- të japë autorizim të përgjithshëm për sigurimin e shërbimeve postare gjatë notifikacionit të parashtruar,

- të mundësojë dhe sigurojë kushte për qasje të njëjtë në rrjetin postar,

- ta ndjekë sigurimin e shërbimit universal,

- të formojë fond kompensues dhe të menaxhojë me mjetet nga fondi kompensues,

- t'i miratojë dhe kryejë kontroll të shpenzimeve për sigurim të shërbimit universal,
- ta ndjekë punën e dhënësve të shërbimeve postare në pajtim me këtë ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të tij,
- ta ndjekë zhvillimin e tregut të shërbimeve postare dhe ta promovojë konkurrencën e tregut të shërbimeve postare,
- të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll të punës së dhënësve të shërbimeve postare dhe të ndërmarrë masa në pajtim me ligjin kundër dhënësve të shërbimeve postare të cilët nuk i zbatojnë dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji,
- të udhëheqë procedura administrative dhe të marrë vendime për procedurë administrative në pajtim me dispozitat e këtij ligji dhe të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative,
- të udhëheqë procedura për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet dhënësve të shërbimeve postare dhe shfrytëzuesve të tyre, ndërmjet dhënësit të shërbimeve universale dhe dhënësve tjerë të shërbimeve postare,
- të kërkojë të dhëna dhe informata nga dhënësit e shërbimeve postare,
- të vendosë, mirëmbajë dhe azhurnojë bazë elektronike të të dhënave,
- të japë mendim dhe të marrë pjesë gjatë përpilimit të ligjeve, dispozitave dhe akteve tjera që u përkasin shërbimeve postare, si dhe gjatë lidhjes, përkatësisht qasjes së Republikës së Maqedonisë në marrëveshjet ndërkombëtare nga sfera e shërbimeve postare dhe ta sigurojë zbatimin e tyre,
- të bashkëpunojë me organe dhe institucione tjera shtetërore,
- ta kryejë punën e saj në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese, duke u mundësuar palëve të interesuara të japin vërejtje dhe komente në lidhje me iniciativat, masat dhe vendimet e Agjencisë,
- të sigurojë informata për shfrytëzuesit dhe dhënësit e shërbimeve postare dhe organizatave dhe trupave ndërkombëtare,
- ta realizojë aplikimin e standardeve nacionale dhe ndërkombëtare dhe dispozitave teknike në sferën e shërbimeve postare,
- të marrë pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare dhe shoqatave të trupave nacionalë rregullatorë në sferën e shërbimeve postare dhe
- të kryejë edhe punë tjera në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 10 Statuti i Agjencisë

- (1) Puna e Agjencisë më afërsisht rregullohet me Statutin e Agjencisë.
- (2) Statuti i Agjencisë posaçërisht përmban dispozita për:
- shenjën mbrojtëse dhe selinë e Agjencisë,
 - përgatitjen dhe përdorimin e vulës së Agjencisë,
 - përfaqësimin e Agjencisë,
 - procedurën për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit të Agjencisë,
 - procedurën për miratimin e akteve nënligjore dhe akteve të përgjithshme të Agjencisë,
 - procedurën për punësim në Agjenci,
 - procedurën për shpërbllim dhe dënim të të punësuarve në Agjenci,
 - procedurën për aftësim profesional dhe profesionalizim të të punësuarve në Agjenci,
 - obligimin për të punësuarit në lidhje me ruajtjen e besueshmërisë së të dhënave dhe
 - dispozita tjera me rëndësia për punën e Agjencisë.
- (3) Statuti i Agjencisë është i arritshëm publikisht dhe shpallet në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 11 Ndikimi i publikut

- (1) Organet shtetërore dhe Agjencia kanë obligime që gjatë përcaktimit të masave që i përkasin tregut për shërbimet postare edhe para marrjes së vendimeve me zbatim të përgjithshëm të cilat në mënyrë të rëndësishme ndikojnë në treg, si dhe gjatë miratimit të dispozitave ta marrin parasysh dhe mendimin e palëve të interesuara.
- (2) Agjencia i shpall propozimet e dispozitave dhe i fton të gjitha palët e interesuara t'i japin propozimet e tyre sugjerime në periudhë që nuk duhet të jetë më e shkurtër se 15 ditë nga dita e shpalljes së propozimeve të rregullave.
- (3) Agjencia mund të organizojë debat publik për dispozitat e propozuara, në të cilin mund të ftohen përfaqësuesit e të gjitha palëve të interesuara që t'i prezantojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e veta për lëndën e propozuar të debatit.
- (4) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (2) të këtij neni, e para miratimit të rregullës, Agjencia ka për detyrë që publikisht t'i shpallë mendimet dhe komentet e parashtruara, me ç'rast informatat dhe të dhënat e fshehta nuk publikohen.

Neni 12 Përgjegjësia për punën e Agjencisë

- (1) Agjencia për punën e saj përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.
- (2) Agjencia për punën e saj obligohet që në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë të dorëzojë raport vjetor për punën për vitin paraprak dhe program vjetor për punën për vitin e ardhshëm.
- (3) Raporti vjetor për punën për vitin paraprak dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë deri më 31 mars në vitin rrjedhës dhe i njëjti posaçërisht përmban:
- raport për aktivitetet e kryera të Agjencisë në vitin paraprak,
 - raport për gjendjen e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak,
 - raport për gjendjen e mjeteve në fondin kompensues për shërbime universale gjatë formimit të tij,
 - raport për zbatimin e planit financiar të Agjencisë për vitin paraprak dhe raport financiar për vitin paraprak (llogari vjetore) dhe
 - raport revizor të përpunuar nga revizorë të jashtëm dhe të pavarur.
- (4) Programi vjetor për punën e Agjencisë për vitin e ardhshëm dorëzohet në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë deri më 30 nëntor në vitin vijues, kurse Kuvendi i Republikës së Maqedonisë e miraton më së voni deri më 31 dhjetor në vitin e njëjtë. Programi vjetor për punë, përmban:
- program për punën për vitin e ardhshëm,
 - plan financiar për vitin e ardhshëm dhe
 - vendim për vlerën e poenit nga neni 28 paragrafi (6) i këtij ligji.
- (5) Raporti vjetor dhe programi vjetor për punën e Agjencisë nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, publikisht janë të arritshëm dhe të njëjtë publikohen në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 13 Organet e Agjencisë

Organet e Agjencisë janë komisioni dhe drejtori.

Neni 14 Komisioni

- (1) Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë që i emëron dhe shkarkon Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Komisioni nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh dhe shkarkon kryetar dhe zëvendëskryetar të Komisionit në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në Rregulloren për punën e Komisionit.

(3) Si anëtarë të Komisionit mund të emërohen persona të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë dhe kanë kryer arsim të lartë nga sfera e shkencave teknike, komunikacioni postar, drejtësia ose ekonomia, me përvojë pune mbi pesë vjet dhe me njohuri të posaçme nga sfera e komunikacionit postar.

(4) Anëtarët e Komisionit emërohen me mandat prej pesë vitesh.

(5) Anëtarët e Komisionit nuk mund të emërohen më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

(6) Anëtarët e Komisionit emërohen jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësve të tyre. Nënkyetari është i detyruar që ta njoftojë Komisionin për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, për skadimin e mandatit të anëtarëve të Komisionit jo më vonë se 60 ditë para skadimit të tij.

(7) Nëse procedura për emërim nuk ka përfunduar para skadimit të mandatit të Komisionit, anëtarët e Komisionit mandati i të cilëve ka skaduar, do të vazhdojnë ta kryejnë funksionin e tyre, por jo më shumë se gjashtë muaj.

(8) Gjatë kohës së mandatit të tij, anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, anëtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, persona që kryejnë detyra në organet dhe trupat e partive politike, anëtarë të organeve administrative dhe mbikëqyrëse të ndërmarrjeve publike, si dhe anëtarë të llojit tjetër të asociacionit të personave fizikë dhe juridikë të cilët do të mund të shkaktojnë konflikt të interesave.

(9) Anëtari i Komisionit, bashkëshorti i tij martesor ose jashtëmartesor, si dhe farefisi i afërt në vijë të drejtë deri në brezin e dytë, nuk mund të kenë pjesëmarrje ose aksione, direkt ose indirekt në persona juridikë që kryejnë aktivitete që drejtpërdrejtë janë në kompetencë të Agjencisë.

(10) Nëse anëtari i Komisionit ka interes privat direkt ose indirekt në lidhje me marrjen e vendimeve në kompetencë të Komisionit, anëtari është i detyruar që për këtë ta njoftojë Komisionin. Komisioni vendos për ekzistimin e interesit të tillë dhe pjesëmarrjen e atij anëtari në vendimmarrje për atë çështje.

Neni 15

Mënyra e punës dhe vendimmarrjes së Komisionit

(1) Komisioni punon dhe vendos në mbledhje.

(2) Vendimet e Komisionit merren me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

(3) Kryetari i Komisionit i konvokon mbledhjet e Komisionit me propozim me shkrim të Drejtorit të Agjencisë ose me propozim me shkrim të tre anëtarëve të Komisionit. Kryetari i Komisionit i kryeson mbledhjet e Komisionit dhe e përfaqëson Komisionin, e në rast të mungesës ose pengesës së tij, obligimet i kryen zëvendëskryetari i Komisionit.

(4) Si anëtarë të Komisionit mund të emërohen persona të punësuar në persona tjerë juridikë, por jo edhe në persona tjerë juridikë të cilët mund të jenë në konflikt interesash, në pajtim me këtë ligj.

(5) Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë në:

- kompensim mujor në lartësi deri në dy rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikës në pajtim me Statutin e Agjencisë dhe

- kompensim për shpenzime të udhëtimit për ata anëtarë të Komisionit që jetojnë jashtë Shkupit kur janë të pranishëm në mbledhje të Komisionit dhe kompensim për shpenzime të udhëtimit, vendosje dhe mëditje për udhëtim zyrtar në pajtim me ligj.

(6) Kompensimi mujor nga paragrafi (5) i këtij neni nuk paguhet nëse në muajin vijues nuk mbahet mbledhje, si dhe për joprani në mbledhjen e mbajtur.

(7) Mjetet e kompensimit mujor dhe të shpenzimeve tjera nga paragrafi (5) i këtij neni të anëtarëve të Komisionit, sigurohen nga mjetet e Agjencisë të përcaktuara me planin financiar.

(8) Vendimet që i merr Komisioni publikohen në ueb faqen e Agjencisë, në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

(9) Puna e Komisionit dhe mënyra e marrjes së vendimeve më afërsisht rregullohet me Rregulloren e punës së Komisionit.

Neni 16

Kompetencat e Komisionit

Komisioni është kompetent që:

- të miratojë statut pas marrjes të pëlqimit paraprakisht nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë,

- të miratojë akte nënligjore dhe akte tjera për zbatimin e këtij ligji,

- të miratojë akte të përgjithshme për punën e Agjencisë, të përcaktuara me Statutin e Agjencisë, e me propozim të drejtorit të Agjencisë,

- të miratojë rregullore për punën e saj në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë,

- të miratojë vendime për vlerën e poenit,

- ta miratojë raportin vjetor për punën për vitin paraprak të Agjencisë dhe llogarinë vjetore,

- ta miratojë programin vjetor për punën për vitin e ardhshëm të Agjencisë,

- ta emërojë dhe shkarkojë drejtorin e Agjencisë në pajtim me këtë ligj dhe në procedurën e përcaktuar në Statutin e Agjencisë,

- ta ndjekë zbatimin e programit vjetor për punën e Agjencisë nëpërmjet raporteve tremujore të dorëzuara nga drejtori i Agjencisë,

- të bashkëpunojë me organe dhe institucione tjera shtetërore, organe të njësisë të vetadministrimit lokal dhe me organizata joqeveritare dhe shoqata të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë,

- të japë mendime, rekomandime dhe propozime në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë dhe organe dhe institucione tjera shtetërore nga sfera e komunikacionit postar dhe

- të kryejë edhe punë të tjera të miratuara me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë.

Neni 17

Shkarkimi i anëtarit të Komisionit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Komisionit për Çështje të Zgjedhjeve dhe Emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, mund të shkarkojë anëtar të Komisionit para kalimit të mandatit:

- me kërkesë të tij,

- nëse është gjykuar për vepër penale për të cilën i është kumtuar dënim me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj ose i është kumtuar masë kundërvajtëse për ndalimin e ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj dhe

- nëse pa arsye ka munguar në tri mbledhje të njëpasnjëshme të Komisionit ose gjithsej në pesë mbledhje gjatë një viti.

(2) Mosdorëzimi i raportit vjetor për punën ose programit vjetor për punën e Agjencisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë, mund të jetë shkak për shkarkim kolektiv të Komisionit.

Neni 18 Drejtori i Agjencisë

(1) Komisioni zgjedh drejtor të Agjencisë nëpërmjet shpalljes publike. Kandidati duhet të jetë me arsimim të lartë dhe përvojë pune mbi pesë vjet. Gjatë zgjedhjes do të merret parasysh përvoja profesionale dhe menaxhuese në sferën në kompetencë të Agjencisë.

(2) Komisioni obligohet që të zgjedhë drejtor jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të drejtorit.

(3) Drejtori, bashkëshorti i tij martesor ose jashtëmartesor, si dhe farefisi i afërt në vijë të drejtë deri në brezin e dytë, nuk mund të ketë pjesëmarrje ose aksione, direkt ose indirekt në persona juridikë që kryejnë aktivitete që drejtpërdrejt janë në kompetencë të Agjencisë.

(4) Drejtori është profesionalisht i angazhuar në Agjenci me orar pune të plotë.

Neni 19 Të drejtat dhe obligimet e drejtorit

(1) Drejtori udhëheq me punën e Agjencisë, është përgjegjës për punën ligjore të Agjencisë dhe i kryen punët vijuese:

- e përfaqëson dhe e paraqet Agjencinë,
- nënshkruan marrëveshje në emër të Agjencisë,
- merr vendime për çështje për të cilët nuk vendos Komisioni,
- e propozon Statutin, raportin vjetor të punës dhe programin vjetor për punën e Agjencisë,
- jep autorizime në kuadër të kompetencave të tij,
- merr vendime për çështje në kompetencë të Agjencisë,
- miraton aktvendime për persona udhëheqës dhe profesionistë për kryerjen e mbikëqyrjes,
- kujdeset për zbatimin e akteve nënligjore dhe akteve tjera të cilat i miraton Komisioni dhe
- kryen edhe punë tjera të miratuara me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë.

(2) Drejtori ka të drejtë të jetë i pranishëm dhe të marrë pjesë në mbledhjet e Komisionit pa të drejtë vote.

(3) Drejtori obligohet që Komisionit t'i dorëzojë raporte kuartale për realizimin e programit vjetor për punën e Agjencisë.

(4) Mandati i drejtorit është pesë vjet, me mundësi edhe për një mandat pasues.

(5) Drejtori në Komision mund të parashtrojë dorëheqje me shkrim, nga funksioni i tij.

(6) Nëse mandati i drejtorit ka përfunduar, kurse procedura për zgjedhjen e drejtorit nuk ka përfunduar, drejtori vazhdon ta ushtrojë funksionin derisa nuk zgjidhet drejtori, por jo më shumë se gjashtë muaj.

Neni 20 Shkarkimi i drejtorit

(1) Drejtori mund të shkarkohet nga Komisioni në rastet vijuese:

- me kërkesë të tij,
- në rast të pengimit për ushtrimin e funksionit për shkak të sëmundjes më gjatë se gjashtë muaj,
- pranimi i funksionit ose punës që janë në kundërshtim me funksionin e tij të drejtorit,
- nëse është i gjykuar për veprë penale për të cilën i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj ose i është kumtuar sanksion kundërvajtës ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më shumë se gjashtë muaj,
- shkelja e dispozitave të këtij ligj ose të rregullave të miratuara në bazë të tij që mund të përcaktohet nga raporti vjetor për punën e Agjencisë ose
- keqpërdorimi i funksionit sipas raportit revizor nga neni 12 i këtij ligji.

(2) Drejtori kundër të cilit ka filluar procedura për shkarkim, paraprakisht njoftohet për dyshimet e mundshme dhe i mundësohet mbrojtje para Komisionit.

(3) Vendimi për shkarkimin e drejtorit mes tjerash duhet t'i përmbajë shkaqet për shkarkimin e tij, të arsyetuara hollësisht dhe i njëjti shpallet në ueb faqen e Agjencisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tij.

(4) Nëse drejtori është shkarkuar, kurse procedura për emërimin e drejtorit nuk ka përfunduar, funksionin drejtor do ta ushtrojë personi i punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, i cili për atë qëllim do të autorizohet nga Komisioni për periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

Neni 21 Organizimi dhe punësimi në Agjenci

(1) Për kryerjen e punëve të Agjencisë formohet shërbim profesional organizimi i të cilit, fushëveprimi i punës dhe kushtet për punësim më afërsisht rregullohen me aktet e organizimit të brendshëm dhe sistematizimin e punëve dhe detyrave, në pajtim me Ligjin për marrëdhënie pune.

(2) Dispozitat nga Ligji për nëpunës shtetërorë nuk zbatohen te të punësuarit në Agjenci.

Neni 22 Transparenca në punën e Agjencisë

(1) Agjencia organizon mbledhje publike dy herë në vit me të gjithë personat e interesuar, me qëllim që t'u mundësojë që të njoftohen me punën e Agjencisë dhe t'u jepet mundësi t'i shprehin qëndrimet dhe mendimet e veta për përparimin e gjendjeve në sferën e shërbimeve postale në Republikën e Maqedonisë.

(2) Agjencia me akt të përgjithshëm më afërsisht i rregullon:

- procedurat për mënyrën e pranimi të propozimeve nga palët e interesuara,
- mënyrën dhe vendin e shpalljes së vendimeve të veta dhe akteve të tjera,
- të dhënat dhe informatat që Agjencia do t'i shpallë, si dhe mënyrën e qasjes te të njëjtat dhe
- mënyrën e bashkëpunimit me përfaqësuesit e organizatave të shfrytëzuesve të shërbimeve postale.

Neni 23 Financimi, kontabiliteti dhe revizioni i Agjencisë

(1) Puna e Agjencisë financohet nga:

- mjetet e realizuara nga të hyrat nga kompensimet e parapara me këtë ligj dhe
- donacione, hua dhe ndihma tjera financiare dhe teknike.

(2) Plani financiar i Agjencisë, që është pjesë përbërëse e programit vjetor për punën për vitin e ardhshëm të Agjencisë, e përcakton Komisioni Plani financiar i Agjencisë përmban të dhëna për të ardhurat e parapara dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm.

(3) Mjetet e përealizuara nga plani financiar i Agjencisë nga viti paraprak barten në planin financiar të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

(4) Revizionin e punës materiale dhe financiare të Agjencisë e kryen revizori i jashtëm dhe i pavarur i zgjedhur në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

(5) Agjencia obligohet që të udhëheqë kontabilitet të posaçëm për mjetet në fondin kompensues për shërbim universal, pas formimit të tij, si dhe për mjetet nga puna e Agjencisë.

Neni 24

Pagesa e detyrimeve me para

(1) Pagesën e detyrimeve me para, në emër të kompensimeve dhe shpenzimeve të këtij ligji, subjektet obligohen që ta kryejnë në mënyrë dhe në afate të caktuara me akte të veçanta të miratuara nga ana e drejtorit të Agjencisë, në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(2) Aktet e veçanta nga paragrafi (1) të këtij neni, kanë karakter të dokumentit përmbartues dhe përfaqësojnë bazë për zbatimin e procedurës për arkëtim të detyrueshëm në pajtim me Ligjin për përmbartim.

Neni 25

Sigurimi i të dhënave dhe informatave nga dhënësit e shërbimeve postare

(1) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që Agjencisë, për kryerjen e kompetencave të veta, rregullisht t'i dorëzojnë të dhëna dhe informata financiare të lidhura me sigurimin e shërbimeve postare.

(2) Agjencia i përcakton llojet e të dhënave dhe informatave financiare të lidhura me sigurimin e shërbimit postar nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, dhënësit e shërbimeve postare janë të obliguar dhe me kërkesë të Agjencisë të dorëzojnë informata dhe të dhëna, në sasi dhe në afatin e përcaktuar në kërkesë. Në kërkesë Agjencia e thekson shkaktun për informatat dhe të dhënat e kërkuara.

(4) Informatat dhe të dhënat nga paragrafi (3) i këtij neni të cilat i kërkon Agjencia duhet të jenë të arsyetuara, të mbështetura në bazë të arsyeshme dhe proporcionale me qëllimin për të cilin do të përdoren.

(5) Agjencia gjatë kryerjes së kompetencave të veta bashkëpunon me organe dhe trupa tjerë shtetërorë, për çështje që janë në lidhje me shërbimet postare.

(6) Agjencia, trupat tjerë rregullatorë dhe organet dhe trupat tjerë nga paragrafi (5) të këtij neni, janë të obliguar që të shkëmbejnë të dhëna dhe informata që janë të nevojshme për kryerjen e kompetencave të veta, vëllimi i shkëmbimit i të cilave është i kufizuar në të dhëna dhe informata që janë adekuate dhe proporcionale për qëllimet për të cilat shkëmbehen.

(7) Agjencia mundet që informatat e fshehta të marra nga trupa tjerë rregullatorë dhe organet tjera shtetërore dhe trupa nga paragrafi (5) i këtij neni, t'i shfrytëzojë vetëm për qëllime për të cilat ato janë kërkuar me respektimin e fshehtësisë së të njëjtave.

Neni 26

Evidenca dhe ruajtja e të dhënave nga dhënësit e shërbimeve postare

(1) Agjencia mban evidencë dhe e ruan dokumentacion që përmban të dhëna për:

- dhënësit e shërbimeve postare,
- marrëveshjet për qasje në rrjetin postar të lidhur ndërmjet dhënësit të shërbimit universal dhe dhënësve të shërbimeve postare,
- llogaritë për kompensime dhe shpenzime për sigurimin e shërbimit universal,
- të dhëna për rrjetin postar dhe infrastrukturën postare dhe
- të dhëna tjera që i përcakton Agjencia.

(2) Agjencia mban evidencë dhe i ruan të dhënat për dhënësit e shërbimeve postare, që kanë të bëjnë me:

- emrin, selinë, logon, NUT, NUAS, numrin dhe datën e regjistrimit në Regjistrin Qendror të Republikës së Maqedonisë, emrin dhe adresën e përfaqësuesit juridik për personat juridikë;
- notifikacionin për shërbimet postare,

- të dhënat për lejen e dhënë, ose autorizimin e përgjithshëm, për llojet e shërbimeve postare dhe të dhënat tjera që janë pjesë përbërëse të lejes ose autorizimit, si dhe të dhëna për ndërprerjen e vlefshmërisë së tyre,

- të dhënat për informim dhe të dhënat për vendime të mundshme për ndalim të sigurimit të shërbimeve postare,

- të dhënat për përmbushjen e detyrimeve të dhënësve të shërbimeve postare që dalin nga ky ligj,

- të dhënat për sanksionet që janë kumtuar për kundërvajtje të kryer, në pajtim me këtë ligj dhe

- dokumentet e tjera që do t'i përcaktojë Agjencia.

(3) Agjencia mban evidencë dhe e ruan dokumentin nga paragrafi (1) të këtij neni në bazën e vet elektronike të të dhënave.

Neni 27

Qasja në dokumentacionin e Agjencisë

(1) Dokumentacioni për të cilin Agjencia mban evidencë në bazën elektronike të të dhënave në përputhje me nenin 26 të këtij ligji, është i kapshëm publikisht përveç të dhënave të fshehta.

(2) Dokumentacioni nga paragrafi (1) i këtij neni ka të bëjë me:

- dokumentet e Agjencisë nga neni 26 i këtij ligji,
- dokumentacionin për mbikëqyrje të kryer dhe kontroll të tregut postar,
- të dhënat, informatat dhe publikimet për të cilat Agjencia konsideron se kontribuojnë për treg të hapur dhe konkurrues postar dhe
- dokumentet e tjera për dhënësit e shërbimeve postare që do t'i përcaktojë Agjencia.

(3) Për publikum nuk do të jetë i arritshëm dokumentacioni, nëse nuk është rregulluar ndryshe me këtë ligj, ndërsa ka të bëjë me:

- aktet për personat e punësuar në Agjenci dhe akte për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të Agjencisë,
- dokumentacionin personal dhe shëndetësor për të punësuarit dhe dokumentacionin tjetër zbulimi i të cilit do të nënkuptojë cenim të privatësisë,
- dokumentet që përmbajnë informata për pronën e ofruesve të shërbimeve postare,
- dokumentet për sekrete zyrtare, informata komerciale, financiare dhe teknike, për ofruesit e shërbimeve postare,
- dokumentet e dorëzuara te gjykatat kompetente deri në përfundimin e procedurës,

- dokumentet të cilat kanë të bëjnë me konteste ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare dhe ndërmjet ofruesve të shërbimeve postare dhe shfrytëzuesve të shërbimeve postare deri në përfundimin e kontestit dhe

- dokumentet që nuk janë të arritshme për publikum me fuqi të ligjit.

(4) Agjencia obligohet që t'i japë për inspektim dokumentet nga paragrafi (3) të këtij neni, me kërkesë të gjykatës për udhëheqje të procedurës gjyqësore.

(5) Me statusin e Agjencisë përcaktohet obligimi i të punësuarve për ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave të cilat nuk janë të arritshme publikisht.

Neni 28

Obligimi për pagesë të kompensimit ndaj Agjencisë

(1) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që Agjencisë t'i paguajnë kompensim në bazë vjetore, prej përpara, për vitin rrjedhës, për shpenzimet për punë të Agjencisë për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Kompensimin nga paragrafi (1) të këtij neni, dhënësit e shërbimeve postare obligohen që ta paguajnë më së voni deri në 31 janar për çdo vit në llogari të Agjencisë.

(3) Lartësia e kompensimit nga paragrafi (1) të këtij neni, e paraqet prodhimin nga numri i poenëve dhe vlera e poenit.

(4) Numri i poenëve nga paragrafi (3) të këtij neni, për sigurimin e shërbimeve postare në komunikacionin e brendshëm postar në bazë të autorizimit të përgjithshëm, është:

- prej 20 deri në 50 poenë për dërgesa postare deri në 2 kg,
- prej 20 deri në 50 poenë për pako deri në 10 kg,
- 10 poenë plotësues për shërbime me vlerë dhe me rekomandim dhe
- 10 poenë për dërgesa postare mbi 2 kg dhe pako mbi 10 kg.

(5) Numri i poenëve nga paragrafi (3) të këtij neni, për sigurimin e shërbimeve postare në komunikacionin ndërkombëtar postar në bazë të autorizimit të përgjithshëm, është:

- 25 poenë për dërgesa deri në 2 kg,
- 25 poenë për pako deri në 10 kg dhe
- 5 poenë për dërgesa postare mbi 2 kg dhe pako mbi 10 kg.

(6) Numri i poenëve nga paragrafi (3) të këtij neni, për sigurimin e shërbimeve universale në bazë të lejes individuale është 50 000 poenë, pa dallim të numrit të dhënësve të shërbimit universal në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(7) Vlerën e poenit nga paragrafi (3) të këtij neni, e përcakton Komisioni i Agjencisë në nivel vjetor, me vendim. Në llogaritjen e vlerës së poenit, merren parasysh zërat e shpenzimeve nga plani financiar i Agjencisë për kryerjen e aktiviteteve dhe detyrave të dhëna në programin vjetor për punën e Agjencisë. Vendimi për vlerën e poenit përmban arsyetim për shkaqet e pranimit apo ndryshimit të vlerës së poenit dhe qëllimet të cilat planifikohen të arrihen në këtë mënyrë.

(8) Mënyrën e përcaktimit të numrit të poenëve për sigurimin e shërbimeve postare në kufijtë e përcaktuar në paragrafi (4) alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, e përcakton Komisioni i Agjencisë, me ç'rast merren parasysh lloji dhe sasia e shërbimeve postare që i siguron dhënësi i shërbimeve postare.

(9) Sasia e dërgesave postare për persona të verbër dhe pjesërisht të verbër, nuk merret parasysh gjatë përcaktimit të numrit të poenëve.

(10) Vendimi nga paragrafi (9) i këtij neni, është pjesë përbërëse e planit vjetor për punën e Agjencisë. Vendimi bashkë me arsyetimin shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(11) Drejtori i Agjencisë miraton aktvendim, me të cilin përcaktohet lartësia e kompensimit nga paragrafi (1) të këtij neni.

(12) Aktvendimi nga paragrafi (11) i këtij neni është përfundimtar, ndërsa pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedurë për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

III. SHËRBIMI UNIVERSAL

Neni 29

Shtrirja e shërbimit universal

(1) Çdo shfrytëzues ka të drejtë shërbimi universal i cili sigurohet me kualitet të përcaktuar me çmime të kapshme në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(2) Shërbimi universal i përfshin:

- pranimin, bartjen, klasifikimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare me peshë deri në 2 kg,
- pranimin, bartjen, klasifikimin dhe shpërndarjen e pakove me peshë deri në 10 kg,
- dërgesat e rekomanduara postare dhe dërgesat me vlerë të shënuar dhe
- pranimin, bartjen, klasifikimin dhe shpërndarjen e dërgesave postare për persona të verbër dhe për persona me shikim pjesërisht të dëmtuar.

(3) Agjencia mund ta rritë shtrirjen e shërbimit universal me pako deri në peshë e cila nuk është më e madhe se 20 kg dhe mund të përkufizojë kushte të posaçme për dërgimin e pakove të këtilla në varësi nga gjendja e tregut të shërbimeve postare në Republikën e Maqedonisë, si dhe në varësi nga nevojat e shfrytëzuesve të shërbimeve postare.

(4) Për dimensionet dhe karakteristikat e tjera të dërgesave postare në komunikacionin ndërkombëtar postar, zbatohen aktet e Lidhjes Postare Botërore.

(5) Shërbimi universal i përkufizuar me këtë ligj i përfshin shërbimet postare nga komunikacioni postar i brendshëm dhe ndërkombëtar.

Neni 30

Sigurimi i shërbimit universal

(1) Shërbimi universal sigurohet në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë vazhdimisht, me kualitet të përcaktuar dhe me çmime të arritshme për të gjithë shfrytëzuesit.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që ta sigurojë shërbimin universal çdo ditë pune, mirëpo jo më pak se pesë herë në javë, së paku një grumbullim dhe një dërgim të dërgesave postare në banesën apo lokalet e secilit person juridik apo fizik.

(3) Sigurimi i shërbimit universal mund të ndërpritet vetëm në rast të fuqisë madhore apo në kushte të cilat paraqesin rrezik për dhënësin e shërbimit universal.

(4) Të dhënat dhe informatat për shërbimin universal të cilat dhënësi i shërbimit universal obligohet t'i shpallë, janë të përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

Neni 31

Kualiteti i sigurimit të shërbimit universal

(1) Agjencia i përcakton kërkesat për kualitetin e shërbimeve të përfshira me shërbimin universal, parametrat për kualitetin dhe matjen e tyre, në pajtim me CEN standardet të përcaktuara për matjen e kualitetit të shërbimit universal.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që ta sigurojë shërbimin universal në pajtim me kërkesat e përcaktuara për kualitet nga paragrafi 1 i këtij neni.

(3) Agjencia e ndjek kualitetin e shërbimit universal dhe sipas nevojës ndërmerr masa adekuate në pajtim me këtë ligj.

(4) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të kryejë matje të kualitetit të sigurimit të shërbimit universal në komunikacionin postar të brendshëm dhe ndërkombëtar, në bazë të metodologjisë së përcaktuar në pajtim me CEN standardet.

(5) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që ta dërgojë metodologjinë nga paragrafi (4) të këtij neni për miratim në Agjenci.

(6) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që ta kryejë matjen e kualitetit të sigurimit të shërbimit universal në komunikacionin postar të brendshëm dhe ndërkombëtar, nëpërmjet kompanisë së pavarur të caktuar nga ana e tij. Të dhënat nga matja e kryer një herë në vit i dërgon në Agjenci.

(7) Agjencia i kontrollon të dhënat nga paragrafi (6) të këtij neni dhe mundet me detyrë zyrtare të zbatojë procedurë të revizionit për kontrollin e vërtetësisë së tyre nëpërmjet kompanisë së pavarur, në llogari të dhënësit të shërbimit universal.

(8) Agjencia i përpunon dhe i vlerëson të dhënat e marra me matjen e kualitetit të sigurisë së shërbimit universal dhe të njëjtat i publikon në ueb faqen e vet.

(9) Nëse dhënësi i shërbimit universal nuk i arrin parametrat e përcaktuara për kualitetin tri herë të njëpasnjëshme, Agjencia mund të fillojë procedurë për revokimin e tij dhe të caktojë dhënës të ri të shërbimit universal.

Neni 32

Kompensimi për sigurimin e shërbimit universal

(1) Dhënësi i shërbimit universal ka të drejtë të kompensimit të shpenzimeve neto që janë bërë me sigurimin e shërbimit universal, nëse dëshmon se shpenzimet janë më të larta nga të hyrat e realizuara nga sigurimi i shërbimit universal në vitin paraprak.

(2) Dhënësi i shërbimit universal ka të drejtë të kompensimit me të cilin do të mbulohej dallimi ndërmjet të hyrave dhe shpenzimeve nga paragrafi (1) të këtij neni.

(3) Metodologjia e përcaktimit të shpenzimeve neto të dhënësit të shërbimit universal dhe llogaritjen e tyre, si dhe mënyrën e llogaritjes së kompensimit nga paragrafi (1) të këtij neni, i përcakton Agjencia.

Neni 33

Procedura për realizimin e të drejtës për kompensimin e shpenzimeve neto për sigurimin e shërbimit universal

(1) Për realizimin e të drejtës për kompensim nga neni 32 paragrafi (1) të këtij ligji, dhënësi i shërbimit universal në Agjenci parashtron kërkesë. Me kërkesë është e nevojshme që të parashtrojë edhe llogari për shpenzimet neto të bëra me përmbushjen e obligimit për sigurimin e shërbimit universal, të mbështetur me raportin financiar dhe informata tjera të kontabilitetit, të bazuara në raportin e reviduar vjetor për vitin paraprak, jo më vonë se 31 marsi i vitit rrjedhës.

(2) Agjencia e kontrollon vërtetësinë e të dhënave, me ç'rast mund të angazhojë revizor të pavarur.

(3) Të dhënat e bëra për revizionin nga paragrafi (2) të këtij neni i paguan dhënësi i shërbimit universal.

(4) Në kërkesë të Agjencisë dhënësi i shërbimit universal obligohet që t'i dërgojë të gjitha të dhënat dhe informatat të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet neto për sigurimin e obligimit nga shërbimi universal.

(5) Drejtori i Agjencisë miraton aktvendim me të cilin përcaktohet lartësia e kompensimit, përkatësisht aktvendim me të cilin në bazë të llogaritjeve përcakton se dhënësi i shërbimit universal nuk ka të drejtë të kompensimit apo ka të drejtë të kompensimit më të vogël të shpenzimeve neto nga ai që e ka propozuar dhënësi.

(6) Aktvendimi nga paragrafi (5) i këtij neni është i plotfuqishëm, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedurë për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 34

Fondi kompensues për financimin e shërbimit universal

(1) Agjencia formon fond kompensues me hapje të llogarisë rrjedhëse të posaçme me të cilin menaxhon dhe për atë mban kontabilitet të posaçëm.

(2) Fondi kompensues përbëhet nga mjetet nga dhënësit e shërbimeve postare dhe shërben për pagesën e kompensimit të shpenzimeve neto të dhënësit të shërbimit universal nga neni 32 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Mjetet për pagesë të kompensimit nga neni 32 paragrafi (1) i këtij ligji sigurohen nga dhënësit e shërbimeve postare të cilët realizojnë minimum të hyra bruto në lartësi të përcaktuar nga Agjencia (në tekstin e mëtejshëm: dhënës të ngarkuar).

(4) Agjencia e përcakton shumën e mjeteve nga paragrafi (2) i këtij neni dhe ajo nuk guxon të jetë më pak se 2% dhe jo më tepër se 4% nga të hyrat e përgjithshme që realizohen me sigurimin e shërbimeve postare nga ana e të gjithë dhënësve të ngarkuar që i nënshtrohen obligimit për pagesën e mjeteve sipas paragrafit (3) të këtij neni.

(5) Dhënësi i shërbimit universal në të cilin kontributi i llogaritur në fondin kompensues është më i vogël se kompensimi i llogaritur për obligimin për sigurimin e shërbimit universal, nuk do të paguajë në fondin kompensues. Si kompensim i dhënësit të shërbimit universal do të përcaktohet vetëm dallimi ndërmjet kompensimit të llogaritur dhe kontributit të llogaritur.

Neni 35

Të hyrat për fondin kompensues

(1) Me qëllim që të përcaktohen të hyrat e përgjithshme të dhënësve të shërbimeve postare, Agjencia lëshon formular të posaçëm që dhënësit e shërbimeve postare janë të obliguar ta plotësojnë dhe t'ia dërgojnë Agjencisë çdo vit deri më 30 prill. Nëse dhënësit e shërbimeve postare edhe pas kalimit të këtij afati nuk dërgojnë të dhëna, Agjencia i shfrytëzon të dhënat për të hyrat e përgjithshme të dhënësve të shërbimeve postare nga llogaria vjetore për vitin paraprak.

(2) Agjencia e kontrollon vërtetësinë e të dhënave, me ç'rast mund të angazhojë revizor të pavarur.

(3) Shpenzimet e bëra për revizionin nga paragrafi (2) të këtij neni, i paguan dhënësi i shërbimit postar.

(4) Dhënësit e ngarkuar janë të obliguar që t'i paguajnë mjetet nga paragrafi (2) i këtij neni në llogarinë e posaçme të Agjencisë, më së voni deri më 31 maj në vitin rrjedhës për vitin paraprak në bazë të aktvendimit të lëshuar nga Agjencia.

(5) Agjencia nga fondi kompensues kryen pagesë të mjeteve të dhënësit të shërbimit universal në bazë vjetore për kompensimin e shpenzimeve neto për sigurimin e shërbimit universal.

(6) Llogaria nga neni 34 paragrafi (1) të këtij ligji revidohet në nivel vjetor nga revizori i pavarur i angazhuar nga dhe për llogari të Agjencisë.

Neni 36

Qasja në shërbimin universal

(1) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të sigurojë pika për qasje në shërbimin universal, edhe atë njësi postare, si dhe sëndukë postare nëpër rrugë.

(2) Agjencia i përcakton kriteret për qasje në shërbimin universal, me përcaktimin e rajonit të njësive të rrjetit, në distancën ndërmjet njësive postare, numrin e sëndukëve postarë dhe të ngjashme.

(3) Për çdo ndryshim të planifikuar të rrjetit postar dhënësi i shërbimit universal obligohet që së paku një muaj paraprakisht ta njoftojë Agjencinë.

(4) Për mbylljen e njësive postare më gjatë se gjashtë muaj dhënësi i shërbimit universal duhet të marrë pëlqim paraprak nga Agjencia, për çka dërgon kërkesë në Agjenci.

(5) Pëlqimin nga paragrafi (4) të këtij neni, Agjencia e lëshon në afat prej 15 ditësh nga dita e parashtrimit të kërkesës.

(6) Ndalohej mbyllja e njësive të njësive postare nga ana e dhënësit të shërbimit universal pa pëlqim paraprak nga Agjencia.

Neni 37

Përcaktimi i dhënësit të shërbimit universal

(1) Agjencia mund të caktojë një nga më shumë dhënës të shërbimeve postare për sigurimin e shërbimit universal, me qëllim që të sigurojë që shërbimi universal të jetë prezent në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

Dhënësi ose dhënësit e shërbimit universal mund të sigurojnë shërbime të ndryshme dhe/ose të përfshijnë pjesë të ndryshme të territorit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Për përcaktimin e dhënësve të shërbimit universal, Agjencia shpall tender publik për zgjedhjen e një ose të më shumë dhënësve të shërbimit universal. Para se të ngritë procedurë për shpalljen e tenderit publik, Agjencia shpall thirrje publike për të deklaruar interes për sigurimin e një apo më shumë shërbimeve të përfshira me shërbim universal. Afati për deklarimin e interesit mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e shpalljes së ftesës publike.

(3) Gjatë përcaktimit të ofruesit ose ofruesve të shërbimit universal, Agjencia obligohet që t'i zbatojë principet e objektivitetit, transparencës, efikasitetit dhe mosdiskriminimit, me ç'rast asnjë person juridik dhe fizik i cili kryen veprimtari nuk do të përjashtohet para kohe nga procedura për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit universal.

(4) Agjencia e përcakton procedurën e tenderit me parakualifikim, nëpërmjet kriterëve objektive dhe transparente për zgjedhjen e ofruesit të shërbimit universal të cilat në veçanti kanë të bëjnë me:

- përgatitjen e kandidatit për të siguruar shërbimin universal në sferën e caktuar dhe

- lartësinë e mjeteve të nevojshme për sigurimin e shërbimit dhe shpenzimin adekuat neto për këtë sigurim dhe shumën adekuate të kompensimit nga fondi kompensues për shërbim universal që e kërkon kandidati që ta sigurojë shërbimin universal.

(5) Për caktimin e dhënësit të shërbimit universal Agjencia miraton vendim. Vendimin për caktimin e dhënësit të shërbimit universal drejtori i Agjencisë e miraton në afat prej 30 ditësh nga skadimi i afatit për paraqitjen e ofertave.

(6) Nëse gjatë procedurës së tenderit nuk kryhet zgjedhja e dhënësit të shërbimit universal, ose nuk ka asnjë ofertë Agjencia merr vendim me të cilin do të caktohen një ose më shumë dhënës të shërbimit universal. Gjatë miratimit të vendimit Agjencia detyrohet që t'i pranojë principet e efektivitetit, objektivitetit dhe transparencës.

(7) Agjencia në mënyrë të vazhdueshme e përcjell punën e ofruesit të shërbimit universal, ndërsa ofruesi është i obliguar që në Agjenci të dorëzojë të dhëna për punën e vet, së paku një herë në vit.

(8) Agjencia organizon debat publik së paku në çdo pesë vite me qëllim që të përcaktojë:

- nëse shërbimi universal sigurohet në mënyrën e përcaktuar dhe adekuate dhe

- nëse ka ofrues që janë të interesuar për sigurimin e një ose më shumë shërbimeve në kuadër të shërbimit universal dhe për cilën pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë.

(9) Nëse Agjencia përcakton se shërbimi universal, respektivisht shërbimet nga përfshirja e shërbimit universal nuk sigurohen në mënyrën e përcaktuar dhe adekuate, Agjencia fillon procedurë për përcaktimin e ofruesit, respektivisht ofruesve të shërbimit universal dhe do të miratojë vendim me të cilin do t'i revokojë obligimet për sigurim të shërbimit universal, respektivisht të shërbimeve nga përfshirja e shërbimit universal të ofruesit paraparak të shërbimit universal.

(10) Agjencia e zbaton procedurën për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal me mënyrën e përcaktuar nga ana e Komisionit të Agjencisë.

(11) Në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e vendimit për përcaktimin e ofruesit të shërbimit universal, drejtori i Agjencisë i lëshon leje individuale.

IV. SIGURIMI I SHËRBIMEVE POSTARE

Neni 38

Kushtet për sigurimin e shërbimeve postare

(1) Para fillimit, ndryshimit ose pushimit të sigurimit të shërbimeve postare, çdo person fizik ose juridik obligohet që të dërgojë notifikacion në Agjenci.

(2) Agjencia në bazë të të dhënave të notifikacionit nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshon autorizim të përgjithshëm për sigurimin e shërbimeve postare (në tekstin e mëtejshëm: autorizim i përgjithshëm).

(3) Për sigurimin e shërbimit universal, Agjencia i lëshon leje individuale personit juridik i cili është caktuar si ofrues i shërbimit universal në pajtim me nenin 37 të këtij ligji.

Neni 39

Notifikacioni

(1) Agjencia e përcakton përmbajtjen dhe formën e notifikacionit dhe dokumentacionin e nevojshëm që dorëzohet me notifikacion.

(2) Notifikacioni nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji, duhet t'i përmbajë veçanërisht të dhënat si në vijim:

- emrin, selinë, NUT dhe NUAS të parashtruesit të notifikacionit, si dhe deklaratën nga përfaqësuesi ligjor me emër, adresë, numër kontakti dhe NUAQ,

- llojin e veprimtarisë së personit juridik ose fizik,
- datën e fillimit, ndryshimit ose ndërprerjes së punëve nga neni 38 paragrafi (1) i këtij ligji,

- rajonin ku do të sigurohen shërbimet postare,
- llojin e shërbimeve postare që do të sigurohen dhe
- të gjitha të dhënat tjera që kërkohen në pajtim me rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji.

(3) Agjencia obligohet që në afat prej 15 ditësh nga marrja e notifikacionit nga paragrafi (1) i këtij neni, i cili nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentacionit nga paragrafi (2) i këtij neni, ta njoftojë parashtruesin e notifikacionit që ta plotësojë notifikacionin me të dhënat e nevojshme në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë.

(4) Agjencia pas notifikacionit të parashtruar nga paragrafi (1) i këtij neni, lëshon autorizim të përgjithshëm në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të dokumentacionit të plotë.

(5) Ofruesi i shërbimeve postare obligohet që ta njoftojë Agjencinë për ndryshimin e të dhënave të lëshuara në notifikacion në afat prej shtatë ditëve nga dita e ndryshimit të shkaktuar ose për ndërprerjen e sigurimit të shërbimeve postare.

Neni 40

Përmbajtja e lejes individuale

(1) Leja individuale veçanërisht i përmban:

- të dhënat për ofruesin e shërbimit universal,
- të drejtat dhe obligimet për sigurimin e shërbimit universal në territorin e Republikës së Maqedonisë dhe

- të drejtat dhe obligimet të cilat ofruesi i shërbimeve universale i ka gjatë kohës së sigurimit të shërbimit universal, siç janë ndërtimi, mbajtja, zhvillimi dhe puna e rrjetit postar dhe infrastruktura përcjellëse, kualiteti i sigurimit me dërgesat postare, si dhe kërkesat tjera dhe obligimet e përcaktuara me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që për të gjitha ndryshimet statusore dhe ndryshimet e strukturës personale, ta njoftojë Agjencinë në afat prej 30 ditësh nga shkaktimi i tyre.

Neni 41

Përmbajtja e autorizimit të përgjithshëm

(1) Autorizimi i përgjithshëm veçanërisht i përmban:
 - të dhënat për bartësin e autorizimit të përgjithshëm,
 - llojin e shërbimeve postare që do të sigurohen dhe
 - të drejtat dhe obligimet për sigurimin e shërbimeve postare në pajtim me këtë ligj dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij.

(2) Ndaloheq që ofruesi i shërbimeve postare të sigurojë shërbime postare të cilat nuk janë të theksuara në autorizimin e përgjithshëm.

(3) Shërbimet postare të rezervuara ofruesit obligohen që t'i sigurojnë me çmim prej së paku dy herë e gjysmë më të lartë nga çmimi me të cilin ofruesi i shërbimeve universale i siguron dërgesat për korrespondencë nga kategoria standarde në shkallën e parë të peshës.

(4) Kufizimet për peshën dhe çmimin nga paragrafi (3) i këtij neni, kanë të bëjnë edhe me shërbimin e postës direkte.

(5) Ndaloheq që ofruesit e shërbimeve postare të sigurojnë shërbime për korrespondencë dhe shërbime të postës direkte nga paragrafi (3) dhe (4), të këtij neni me çmim më të ulët nga kufizimi i përcaktuar.

(6) Ofruesi i shërbimit universal obligohet që për të gjitha ndryshimet statusore ta njoftojë Agjencinë në afat prej 30 ditësh nga shkaktimi i tyre.

Neni 42

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes individuale dhe e autorizimit të përgjithshëm

Leja individuale nga neni 40 dhe autorizimi i përgjithshëm nga neni 41 të këtij ligji, janë me kohë të përcaktuar të vlefshmërisë.

Neni 43

Bartja e të drejtave dhe obligimeve të lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm

(1) Ofruesi i shërbimit universal nuk guxon t'ia bartë të drejtat dhe obligimet e dhëna në leje individuale personit tjetër juridik ose fizik.

(2) Ofruesi i shërbimeve postare nuk guxon t'ia bartë të drejtat dhe obligimet e dhëna në autorizimin e përgjithshëm personit tjetër juridik ose fizik.

Neni 44

Ndryshimi i lejes individuale dhe i autorizimit të përgjithshëm me detyrë zyrtare

(1) Leja individuale dhe autorizimi i përgjithshëm mund të ndryshohen në çdo kohë me detyrë zyrtare.

(2) Nëse procedura për ndryshimin e lejes individuale ose autorizimit të përgjithshëm është ngritur me detyrë zyrtare, Agjencia obligohet që menjëherë t'i njoftojë ofruesit e shërbimeve postare për ndryshimin dhe për shkaqet e ndryshimit.

(3) Agjencia ka të drejtë ta ndryshojë lejen individuale ose autorizimin e përgjithshëm me detyrë zyrtare, nëse:

- kjo është e nevojshme me qëllim që të sigurohet sigurim efikas i shërbimit universal,

- interesi publik kërkon ndryshimin e përfshirjes së shërbimit universal,

- kjo është e nevojshme për mbrojtjen, sigurinë dhe sigurinë shtetërore dhe

- kjo kërket për harmonizimin e ligjeve të Republikës së Maqedonisë dhe akteve ndërkombëtare.

(4) Agjencia ka të drejtë ta ndryshojë autorizimin e përgjithshëm, nëse ofruesi i shërbimit postar nuk i plotëson më tej të drejtat dhe obligimet e dhëna në autorizimin e përgjithshëm.

(5) Agjencia lëshon leje të re individuale ose autorizim të përgjithshëm me të cilin leja e dhënë individuale ose autorizimi i përgjithshëm ndryshohet pjesërisht ose në tërësi.

(6) Leja individuale ose autorizimi i përgjithshëm nga paragrafi (5) i këtij neni janë të plotfuqishme, ndërsa pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedurë për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

Neni 45

Heqja e lejes individuale dhe e autorizimit të përgjithshëm

(1) Leja individuale dhe autorizimi i përgjithshëm mund të hiqen në bazë të vendimit që e miraton drejtori i Agjencisë, në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative.

(2) Procedurën për heqjen e lejes individuale dhe të autorizimit të përgjithshëm, Agjencia e ngrit me detyrë zyrtare.

(3) Nëse nga shkaqe objektive shërbimi universal nuk mund të sigurohet, Agjencia mund ta heqë lejen individuale vetëm pasi të përcaktojë tjetër ofrues të shërbimit universal.

(4) Agjencia e heq lejen individuale dhe autorizimin e përgjithshëm me detyrë zyrtare, nëse:

- bartësi i lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm më tej nuk i plotëson të drejtat dhe obligimet e lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij dhe

- nëse ofruesi i shërbimeve postare tri herë të njëpasnjëshme nuk vepron sipas vendimit për mënjanimin e mangësive të miratuara nga Agjencia.

(5) Heqja e lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm është me ditën e miratimit të aktvendimit.

(6) Aktvendimi nga paragrafi (1) i këtij neni është i plotfuqishëm, ndërsa pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedurë për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(7) Ndaloheq sigurimi i shërbimeve postare pas tërheqjes së lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm.

Neni 46

Ndërprerja e vlefshmërisë së lejes individuale dhe e autorizimit të përgjithshëm

(1) Leja individuale dhe autorizimi i përgjithshëm me fuqi të ligjit shfuqizohen, nëse:

- dhënësi i shërbimeve postare ka pushuar së ekzistuari dhe

- dhënësi i shërbimeve postare nuk ka filluar t'i sigurojë shërbimet postare në afat prej një viti nga lëshimi i lejes individuale ose autorizimit të përgjithshëm, përveç nëse ndryshe nuk është paraparë me të njëjtat.

(2) Për shfuqizim të lejes individuale dhe të autorizimit të përgjithshëm, Agjencia miraton aktvendim.

(3) Aktvendimi nga paragrafi (2) të këtij neni është i plotfuqishëm, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedurë për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(4) Kompensimet që janë paguar për vitin në të cilin janë shfuqizuar, përkatësisht janë hequr apo ndryshuar leja individuale dhe autorizimi i përgjithshëm, nuk kthehen.

(5) Ndaloheq sigurimi i shërbimeve postare pas shfuqizimit të lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm.

V. RRJETI POSTAR DHE KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE

Neni 47

Qasja e dhënësve të shërbimeve postare në rrjetin postar

(1) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që ta ndërtojë, mirëmbajë dhe zhvillojë rrjetin postar dhe infrastrukturën shoqëruese.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që në pajtim me kushtet e përcaktuara me këtë ligj, të mundësojë qasje në rrjetin postar dhe në shërbimet të cilat janë të lidhura me sigurimin e shërbimeve postare të dhënësve të shërbimeve postare.

(3) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që t'i përcaktojë mënyrën dhe kushtet për qasje në rrjetin postar, çmimin për qasje dhe çështje tjera të lidhura me qasjen dhe në formë të ofertës për qasje ta dorëzojë në Agjenci për miratim. Dhënësi i shërbimit universal e mban përgjegjësinë për dëshmi në procedura të ngritura në pajtim me këtë nen. Agjencia jep leje në afat prej 30 ditësh.

(4) Nëse janë të nevojshme informata plotësuese dhe llogaritje, Agjencia mund ta vazhdojë afatin për 15 ditë, pasi paraprakisht do ta njoftojë dhënësin e shërbimit universal.

(5) Agjencia gjatë përcaktimit të çmimit për qasje, dhënësit të shërbimit universal duhet t'i mundësojë shkallë të arsyeshme për kthim të mjeteve investuese, duke i marrë parasysh edhe rreziqet që janë pjesë përbërëse e investimeve.

(6) Të gjitha mekanizmat për kthim të shpenzimeve ose metodologjitë për caktimin e çmimeve që i përcakton Agjencia, përcaktohen ashtu që të shërbejnë për promovimin e konkurrencës efikase dhe të qëndrueshme dhe për rritjen e privilegjeve për shfrytëzuesit, e Agjencia mund t'i marrë parasysh çmimet nga tregjet e krahasueshme konkurruese.

(7) Propozim-çmimet për qasje në rrjetin postar duhet të bazohen në shpenzimet e përcaktuara në bazë jodiskriminuese dhe për shërbime të barabarta të barabarta për të gjithë dhënësit e shërbimeve postare. Dhënësi i shërbimit universal në lidhje me çmimet e orientuara sipas shpenzimeve, obligohet të dëshmojë se çmimet janë nxjerrë nga shpenzimet dhe se në to është përfshirë edhe shkalla për kthim të investimit. Gjatë përcaktimit të harmonizimit të këtij obligimi, Agjencia mund të përdorë metoda të kontabilitetit të cilat janë të pavarura nga ato të cilat i shfrytëzojnë dhënësit e shërbimeve postare, Agjencia mundet, gjithashtu, të vendosë që të kërkojë nga dhënësi i shërbimit universal që t'i arsyetojë çmimet dhe ku është e përshtatshme të kërkojë nga ai t'i ndryshojë çmimet.

(8) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që çmimet për qasje në rrjetin postar, t'i zbatojë ditën e parë nga muaji i ardhshëm i cili vijon pas muajit në të cilin është marrë leja nga Agjencia.

(9) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të lidhë marrëveshje për qasje në rrjetin postar me dhënës tjerë të shërbimeve postare me kërkesë të tyre.

(10) Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje nga paragrafi (9) i këtij neni ose marrëveshja e arritur është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, Agjencia me kërkesë të njëres palë vendos në pajtim me dispozitat nga kreu XII i këtij ligji.

(11) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që t'i dërgojë Agjencisë kopje nga marrëveshja e nënshkruar, si dhe ndryshime dhe plotësime nëse ka.

(12) Nëse marrëveshja për qasje në rrjetin postar nuk lidhet në afat prej 60 ditësh nga pranimi i kërkesës ose marrëveshja e arritur është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, me kërkesë të njëres nga palët Agjencia vepron në pajtim me dispozitat nga kreu XII i këtij ligji.

(13) Dhënësi i shërbimit universal mund të refuzojë qasje në rrjetin postar vetëm në rastet kur dhënia e qasjes në rrjetin postar paraqet kërcënim për sigurimin e shërbimit universal dhe në rast të tillë dhënësi i shërbimit universal e njofton Agjencinë në afat prej shtatë ditësh me paraqitjen e provave pse kërkuksi është refuzuar.

(14) Gjatë përcaktimit të çmimit dhe kushteve për qasje në rrjetin postar, dhënësi i shërbimit universal nuk guxon të bëjë dallim ndërmjet dhënësve të ndryshëm të shërbimeve postare.

(15) Agjencia me iniciativë personale mund t'i urdhërojë dhënësit të shërbimit universal plotësimin e obligimeve të përcaktuara me këtë nen, kur pengesa për qasje në rrjetin postar e arsyetuar nga ana e dhënësit të shërbimit universal, është e pamjaftueshëm, përkatësisht joobjektive.

(16) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që dhënësve të shërbimeve postare me qasjen në rrjetin postar t'u japë edhe kodet postare të lidhura me të dhëna të adresave në bazë të marrëveshjes komerciale.

(17) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të mbajë kontabilitet të posaçëm për aktivitetet e lidhura me qasjen në rrjetin postar.

(18) Palët obligohen që ta mbrojnë fshehtësinë e të gjitha të dhënave të shkëmbyera gjatë lidhjes së marrëveshjes për qasje. Të dhënat nuk guxojnë të shfrytëzohen për asnjë tjetër dedikim ose t'u barten personave të tretë, të cilëve informatat e tilla do t'u mundësonin përparësi konkurruese.

(19) Agjencia me rregullë, në mënyrë më të hollësishme do ta përcaktojë përmbajtjen dhe informatat nga oferta e miratuar për qasje nga paragrafi (3) të këtij neni të cilat dhënësi i shërbimit universal duhet t'i shpallë.

(20) Agjencia mund të kërkojë nga dhënësi i shërbimit universal të kryejë ndryshim të ofertës së lejuar për qasje, përkatësisht të përgatitë dhe dorëzojë ofertë të ripërtëritur dhe të azhurnuar për qasje siç imponojnë kushtet e tregut, përkatësisht rregullat në pajtim me këtë ligj, kurse dhënësi i shërbimit universal mund ta bëjë atë edhe sipas iniciativës së tij.

(21) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të veprojë sipas kërkesës së Agjencisë për ndryshimin e ofertës së miratuar për qasje në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, e Agjencia e lejon ndryshimin e ofertës për qasje në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të saj në Agjenci. Kur dhënësi i shërbimit universal dorëzon në Agjenci ndryshim të ofertës së lejuar për qasje me vetiniciativë, Agjencia obligohet që të prononcohet për të njëjtës në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të saj në Agjenci.

(22) Dispozitat nga paragrafët (7) dhe (18) të këtij neni të cilat kanë të bëjnë me zbatimin dhe shpalljen e ofertave për qasje, kanë të bëjnë edhe me ndryshimet e ofertave të lejuara për qasje.

Neni 48

Kushte të përgjithshme për sigurimin e shërbimeve postare

(1) Agjencia i përcakton Kushtet e përgjithshme për sigurimin e shërbimit universal në të cilat veçanërisht janë përmbajtur llojet e shërbimeve postare, kushtet për pranim, bartje, klasifikim dhe shpërndarje të shërbimeve postare, procedurat për reklamacione dhe kushte tjera të lidhura me sigurimin.

(2) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të miratojnë kushte të përgjithshme për sigurimin e shërbimeve postare dhe të formojnë çmime për shërbime postare të cilat i sigurojnë.

(3) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që çmimet dhe kushtet e përgjithshme nga paragrafi (2) të këtij neni, t'i dorëzojnë në Agjenci dhe t'i shpallin në lokalet e dhënësit të shërbimeve postare dhe në vend të dukshëm. Çdo ndryshim i çmimeve dhe Kushteve të përgjithshme nga paragrafi (2) të këtij neni, dorëzohet në Agjenci në afat prej tri ditësh nga ndryshimet e kryera.

(4) Agjencia me rregullë do t'i parashohë elementet e domosdoshme të kushteve të përgjithshme nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të mbajnë evidencë për numrin e reklamacioneve të parashtruara dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre, kurse të dhënat për numrin dhe mënyrën e zgjidhjes t'i dorëzojnë në Agjenci. Të dhënat e marra nga dhënësit e shërbimeve postare, Agjencia do t'i shpallë në ueb faqen e saj.

Neni 49 Greva

(1) Dhënësit e shërbimeve postare në rast të grevës obligohen që të sigurojnë pranim, bartje, klasifikim dhe shpërndarje të dërgesave postare që shfrytëzohen në procedurat gjyqësore, procedurat administrative dhe procedura në lidhje me kundërvajtjet, si dhe bartje, klasifikim dhe shpërndarje të dërgesave të rekomanduara postare për nevojat e mbrojtjes dhe sigurisë.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) të këtij neni, dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të sigurojnë shpërndarje të dërgesave të rekomanduara dhe të dërgesave me vlerë të shënuar që janë mbledhur para fillimit të grevës.

(3) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të sigurojnë shpërndarje të të gjitha dërgesave të cilat janë të pranuar para hyrjes në grevë, menjëherë pas mbarimit të grevës.

(4) Organi i cili e organizon grevën obligohet që të sigurojë që dërgesat postare të arritura gjatë kohës së grevës të mos dëmtohen, humbin ose të shkatërrohen dhe të gjitha dërgesat e arritura gjatë kohës së grevës të shpërndahen në afat prej dy ditësh pas mbarimit të grevës.

VI. ÇMIMET PËR SIGURIMIN E SHËRBIMEVE POSTARE DHE LLOGARITJET FINANCIARE

Neni 50 Çmimet e shërbimit universal

(1) Për çdo ndryshim të çmimeve për sigurimin e shërbimit universal dhënësi i shërbimit universal obligohet që të parashtrijë kërkesë në Agjenci. Kërkesa për ndryshim të çmimeve për sigurimin e shërbimit universal, duhet të arsyetohet me analizë të shpenzimeve, që të vërtetohet nevoja e vërtetë për ndryshimin e çmimeve.

(2) Dhënësi i shërbimit universal e mban përgjegjësinë e dëshmitit në procedura të ngritura në pajtim me këtë nen.

(3) Me rastin e kërkesës nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia vendos me aktvendim në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të dokumentacionit të tërësishëm. Nëse janë të nevojshme informata dhe llogaritjet plotësuese, Agjencia mund ta vazhdojë afatin për vendosje për 15 ditë, pasi paraprkishtë do ta njoftojë dhënësin e shërbimit universal.

(4) Aktvendimi nga paragrafi (3) i këtij neni është i plotfuqishëm, kurse pala e pakënaqur ka të drejtë të ngritë procedure për kontest administrativ para gjykatës kompetente.

(5) Çmimet për sigurimin e shërbimit universal, të miratuara nga Agjencia, dhënësi i shërbimit universal obligohet që t'i shpallë në ueb faqen e vet dhe në lokalet afariste të dedikuara për shfrytëzues të shërbimeve postare, si dhe t'ua paraqesë shfrytëzuesve të shërbimeve postare për kontroll, me kërkesë të tyre.

(6) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që çmimet e miratuara për sigurimin e shërbimit universal t'i zbatojë ditën e parë nga muaji i ardhshëm i cili vijon pas muajit në të cilin janë miratuar nga Agjencia.

(7) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që çmimet e miratuara t'i paraqesë në shpalljet publike më së paku tetë ditë para fillimit të zbatimit të tyre.

(8) Çmimet për sigurimin e shërbimit universal duhet të jenë:

- të kapshme për të gjithë shfrytëzuesit të shërbimit pavarësisht nga rajoni gjeografik,
- të bazuara në shpenzimet për sigurimin efikas të shërbimit universal,
- transparente dhe të përcaktuara në bazë jodiskriminuese dhe
- të barabartë për shërbime të barabarta në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(9) Me përjashtim nga paragrafi (8) alineja 4 e këtij neni, dhënësi i shërbimit universal mund të përcaktojë çmime të posaçme për shfrytëzuesit e mëdhenj. Çmimi për shfrytëzuesit e mëdhenj duhet të jetë i barabartë për të gjithë shfrytëzuesit e mëdhenj të cilët shfrytëzojnë shërbime postare në kushte të barabarta.

(10) Agjencia me detyrë zyrtare mund të kërkojë ndryshim të çmimeve në bazë të treguesve të marrë nga analiza e tregut.

(11) Agjencia mund të kërkojë nga dhënësi i shërbimit universal të kryejë ndryshim të çmimeve për sigurimin e shërbimit universal, siç imponojnë kushtet e tregut, përkatësisht rregullat në pajtim me këtë ligj.

(12) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të veprojë sipas kërkesës së Agjencisë për ndryshimin e çmimeve për sigurimin e shërbimit universal në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës, kurse Agjencia e miraton ndryshimin e çmimeve për sigurimin e shërbimit universal në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të saj në Agjenci.

Neni 51 Mbajtja e kontabilitetit

(1) Dhënësit e ngarkuar të shërbimeve postare të cilët janë të detyruar të kontribuojnë në fondin kompensues, obligohen që të mbajnë kontabilitet të veçantë për funksionimin e fondit kompensues.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që të mbajë kontabilitet të veçantë për shërbimin universal, për shërbimet e rezervuara, si dhe për shërbimet tjera postare të cilat i siguron. Kontabiliteti i veçantë do të shfrytëzohet për llogaritjen e shpenzimeve neto për shërbimin universal.

(3) Agjencia i përcakton mënyrën e mbajtjes së kontabilitetit dhe çështje tjera të cilat dalin nga ky nen.

(4) Dhënësi i shërbimit universal nuk guxon t'i subvencionojë shërbimet tjera të cilat i siguron, me të hyrat e realizuara me sigurimin e shërbimit universal.

(5) Raportet e reviduara kontabiliste, dhënësi i shërbimit universal i dorëzon një herë në vit në Agjenci.

(6) Dhënësit e ngarkuar janë të detyruar që Agjencisë t'i dorëzojnë informata për sistemin e kontabilitetit të cilin e shfrytëzojnë, si dhe informata të hollësishme kontabiliste të cilat dalin nga ky sistem.

(7) Agjencia e përcakton mënyrën e zbatimit të detyrimit nga paragrafi (6) i këtij neni.

VII. LETRA POSTARE ME VLERË

Neni 52 Letra postare me vlerë

(1) Letrat postare me vlerë janë pulla postare, zarfe të standardizuara postare dhe karta postare me pulla të shtypura postare.

(2) Organi i administratës shtetërore e miraton programin vjetor për emetimin e pullave postare të cilin e dorëzon dhënësi i shërbimit universal.

(3) Dhënësi i shërbimit postar ka të drejtë që:
 - të shtypë pulla postare të rregullta dhe jubilarë,
 - të shtypë zarfe me pullë të shtypur postare dhe kartela postare,
 - të shtypë vula postare jubilarë,
 - të shtypë zarfe filateliste të cilat shtypen në ditën e shtypjes së pullës postare,
 - të botojë katalogë dhe prodhime tjera filateliste,
 - t'i njoftojë operatorët e huaj postarë të cilët janë anëtarë të Lidhjes Postare Botërore për botimin e pullave postare dhe
 - të shet dhe shkëmben kuponë ndërkombëtarë për përgjigje.

(4) Pullat postare duhet të jenë në pajtim me kushtet e përcaktuara në aktet e Lidhjes Postare Botërore.

Neni 53

Pulla të pavlefshme

(1) Dhënësi i shërbimit universal nuk guxon të shfrytëzojë pulla të pavlefshme postare.

(2) Për pullat e pavlefshme postare nga paragrafi (1) i këtij neni, konsiderohen pullat të cilat:

- janë emetuar në kundërshtim me këtë ligj,
- janë dëmtuar,
- tanimë janë shfrytëzuar për pagimin e shërbimeve postare dhe
- nuk janë emetuar nga ana e dhënësit të shërbimit universal.

(3) Nëse pulla e pavlefshme postare është vënë në dërgesën postare, konsiderohet se shërbimi postar nuk është paguar.

VIII. DORËZIMI

Neni 54

Dorëzimi i dërgesave postare

(1) Dhënësi i shërbimeve postare obligohet që dërgesat postare t'i dorëzojnë në sëndukët postarë të shtëpive ose ato grumbullues ose në vendet e ndara postare të vendosura në lokalet afariste të dhënësit të shërbimeve postare, ose obligohet që t'i dorëzojë në banesën e pranuesit ose në lokalet postare të dhënësit të shërbimeve postare, personalisht pranuesit ose personit të autorizuar nga ai.

(2) Letrat gjyqësore dhe letrat e procedurave administrative dorëzohen nga ana e dhënësit të shërbimeve postare dhe në kushte të përcaktuara me ligj tjetër.

(3) Agjencia i përcakton kushtet dhe mënyrën për dorëzim të dërgesave postare me kushtet e përgjithshme nga neni 48 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

Neni 55

Detyrimi për vendosjen e sëndukëve postarë të shtëpive nga shfrytëzuesit e shërbimeve postare

(1) Pranuesi i dërgesave postare obligohet që të sigurojë vendosjen dhe mirëmbajtjen e sëndukut postar të shtëpisë në hyrje të shtëpisë familjare ose ndërtesës individuale të banimit, përkatësisht në hyrje të lokalit afarist, në të cilin do t'i dërgohen dërgesat postare.

(2) Sënduku postar i shtëpisë duhet ta ketë numrin e ndërtesës familjare ose individuale të banimit të lokaleve afariste.

(3) Sëndukët postarë të shtëpive nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të mirëmbahen nga ana e pranuesit në mënyrë që do të sigurojë dorëzim të sigurt të dërgesave postare.

(4) Dhënësit e shërbimeve postare nuk do të kryejnë dorëzim të dërgesave postare nëse nuk janë të siguruara kushtet nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni dhe për këtë janë të detyruar që ta njoftojnë Agjencinë.

Neni 56

Detyrimi për vendosjen e sëndukëve postarë nga dhënësi i shërbimit universal

(1) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që në vende publike dhe rrugë, të vendosë sëndukë postarë që të sigurohet qasje më e mirë në rrjetin e tij dhe shërbim më efikas të shfrytëzuesve.

(2) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që t'i mirëmbajë sëndukët postarë në mënyrë që do të mundësojë siguri të dërgesave postare.

(3) Dhënësi i shërbimit universal obligohet që së paku një herë në ditë, jo më pak se pesë ditë pune në javë, të grumbullojë dërgesa postare të dorëzuara në sëndukët postarë nga paragrafi (1) i këtij neni.

IX. MBROJTJA E SHFRYTËZUESVE TË SHËRBIMEVE POSTARE

Neni 57

E drejta për shfrytëzimin e shërbimeve postare dhe e drejta për kundërshtim

(1) Çdo shfrytëzues ka të drejtë që të shfrytëzojë shërbime postare në pajtim me kushtet e përgjithshme nga neni 48 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji dhe në pajtim me çmimet nga neni 50 të këtij ligji.

(2) Çdo shfrytëzues i shërbimeve postare ka të drejtë kundërshtimi në vendimin ose në procedurën e ndërmarrë nga dhënësi i shërbimeve postare në lidhje me qasjen të shërbimit dhe sigurimin e shërbimeve. Shfrytëzuesi mund të lëshojë kundërshtim të dhënësi i shërbimeve postare në afat prej 30 ditësh nga dita kur do të njoftohet për vendimin ose procedurën e dhënësit të shërbimeve postare.

(3) Nëse dhënësi i shërbimeve postare e refuzon kundërshtimin ose nuk merr vendim në afat prej 30 ditësh nga pranimi i kundërshtimit, shfrytëzuesi i shërbimeve postare me kërkesë mund të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës në Agjenci në afat prej 15 ditësh pas kalimit të këtij afati, në pajtim me dispozitat nga Kreu XII i këtij ligji.

(4) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që ta shpallin procedurën për parashtrimin e kundërshtimit nga ana e shfrytëzuesve të shërbimeve postare në kuadër të kushteve të përgjithshme nga neni 48 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji.

(5) Agjencia do ta rregullojë procedurën për mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve të shërbimeve postare nëpërmjet përcaktimit të procedurave për zgjidhjen e kontesteve, në pajtim me këtë ligj.

X. PRIVATËSIA E DËRGESAVE POSTARE

Neni 58

Fshehtësia e dërgesave postare

(1) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të sigurojnë pacenueshmëri të fshehtësisë së dërgesave postare.

(2) Personat juridikë ose fizikë të cilët sigurojnë shërbime postare obligohen që të sigurojnë pacenueshmëri të fshehtësisë së dërgesave postare edhe pas mbarimit të aktivitetit në të cilin kanë qenë të detyruar ta sigurojnë fshehtësinë.

(3) Të dhënat të cilat të punësuarit të dhënësi i shërbimeve postare nga ky nen do t'i marrin vesh gjatë kryerjes të detyrave të punës, janë të detyruar t'i ruajnë edhe pas pushimit të marrëdhënies së punës të dhënësi i shërbimeve postare.

(4) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që të vendosin sistem i cili do të sigurojë pacenueshmëri të fshehtësisë së shërbimeve postare.

(5) Krahаs dispozitave të përcaktuara në këtë nen procedura dhe mënyra e sigurimit të fshehtësise së dërgesave postare do të kryhet në pajtim me aktet nënligjore të miratuara në bazë të këtij ligji.

Neni 59

Të dhëna për shfrytëzuesit e shërbimeve postare

(1) Dhënësit e shërbimeve postare mund t'i grumbullojnë dhe t'i përpunojnë të dhënat personale të shfrytëzuesve të shërbimeve postare të cilat janë pjesë përbërëse të adresës së dërgesës postare, nëse ato të dhëna u janë të nevojshme për sigurimin e shërbimeve postare.

(2) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që t'i përpunojnë të dhënat nga paragrafin (1) të këtij neni në pajtim me rregullat me të cilat rregullohet mbrojtja e të dhënave personale.

XI. PËRMBAJTJA E DËRGESAVE POSTARE DHE PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN E SHKAKTUAR

Neni 60

Përmbajtja e ndaluar e dërgesave postare

(1) Ndalohet që dërgesat postare të përmbajnë:

- droga dehëse, përveç nëse dërguesi ose pranuesi nuk është person i cili është i autorizuar me ligj të tregtojë ose të shfrytëzojë materiale të tilla,
- materiale eksplozive, ndezëse, radioaktive ose materia tjera të rrezikshme,
- kafshë të gjalla,
- sende importi dhe qarkullimi i të cilave është ndaluar në vendin e destinuar,
- sende që janë të rrezikshme për të punësuarit të dhënësi i shërbimeve postare,
- sende të cilët janë të ndaluar me aktet e Lidhjes Postare Botërore dhe
- materiale dhe sende tjera bartja e të cilave është e ndaluar, në pajtim me këtë dhe ligj tjetër.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) alineja 2 e këtij neni, materiet e rrezikshme të cilat shkëmbehen ndërmjet institucioneve kompetente mund të barten me dërgesa postare në mënyrë dhe me kushte të përcaktuara me ligj.

(3) Me përjashtim nga paragrafi (1) alineja 3 e këtij neni, dërgesat postare të ndryshme nga dërgesat me vlerë të shënuar, lejohet të përmbajnë bletë, shushunja dhe krimba mëndafshi.

(4) Dhënësit e shërbimeve postare obligohen që t'i dorëzojnë dërgesat postare të cilat përmbajnë materiale dhe sende nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, duke e pasur parasysh natyrën e tyre dhe shkallën e rrezikut, të organet dhe institucionet kompetente shtetërore.

(5) Mënyra për veprim me dërgesat për të cilat do të përcaktohet se përmbajnë substanca ose sende nga paragrafi (1) të këtij neni, rregullohen me aktet nga neni 48 të këtij ligji.

Neni 61

Përgjegjësia e dërguesit për përmbajtjen e dërgesave postare

(1) Dërguesi është përgjegjës për paketimin e brendshëm të dërgesës postare.

(2) Dërguesi është përgjegjës për të gjitha dëmet që dërgesa e tij për shkak të paketimit joadekuat i ka shkaktuar në dërgesat tjera postare, në mjetet dhe objektet të dhënësit e shërbimeve postare, si dhe për lëndime ose vdekje të të punësuarve dhe personave tjerë, nëse ato ndodhin për shkak të asaj se dërgesa ka përmbajtur sende bartja e të cilëve është e ndaluar.

(3) Dërguesi obligohet që ta shënojë vlerën reale të përmbajtjes së dërgesës me vlerë të shënuar.

Neni 62

Përgjegjësia e dhënësit të shërbimeve postare për dëmin e shkaktuar

(1) Dhënësit e shërbimeve postare janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar në dërgesën postare me rekomandim, dërgesën me vlerë të shënuar dhe paketin në rast të:

- humbjes, vjedhjes ose dëmtimit të dërgesës dhe
- tejkalimit të afatit për dorëzim.

(2) Me përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, dhënësit e shërbimeve postare nuk do të jenë përgjegjës nëse dëshmojnë se:

- të njëjtat janë të shkaktuara nga fuqia madhore,
- janë me faj të dërguesit,
- organi kompetent e ka marrë ose shkatërruar dërgesën postare e cila përmban materiale ose sende të ndaluar,
- shfrytëzuesi i shërbimeve postare me mashtrim e ka siguruar përmbajtjen e dërgesës postare në shumë e cila e tejkalon vlerën e vërtetë të përmbajtjes,
- dërgesa postare nuk është dorëzuar si pasojë e adresës së pasaktë dhe
- shfrytëzuesi i shërbimeve postare nuk ka bërë reklamacion në pajtim me nenin 63 të këtij ligji.

(3) Në komunikacionin ndërkombëtar postar dhënësit e shërbimeve postare përgjigjen në pajtim me aktet ndërkombëtare të cilat i ka lidhur, përkatësisht i ka pranuar Republika e Maqedonisë.

Neni 63

Reklamacioni

(1) Shfrytëzuesit e shërbimeve postare kanë të drejtë të parashtrorin reklamacion.

(2) Dërguesi ka të drejtë të parashtrorin reklamacion me shkrim të dhënësi i shërbimeve postare në afat prej tre muajsh nga dita e dërgimit të dërgesës.

(3) Shfrytëzuesit e shërbimeve postare mund të parashtrorin reklamacion për dërgesa të thjeshta postare pa të drejtë për kompensim të dëmit.

(4) Pranuesi i shërbimeve postare ka të drejtë të parashtrorin reklamacion menjëherë, nëse dëmtimi është:

- i dukshëm nga jashtë dhe
- në afat prej 24 orëve nga pranimi i dërgesës postare, nëse dëmtimi nuk është i dukshëm nga jashtë, me kusht që pranuesi të dëshmojë se dëmtimi ose zvogëlimi i përmbajtjes së dërgesës postare është shkaktuar para dorëzimit të saj.

(5) Nëse shfrytëzuesi i shërbimeve postare nuk ka parashtruar reklamacion në afatin e paraparë, e humb të drejtën për kompensim të dëmit. (6) Dhënësi i shërbimeve postare obligohet që ta pranojë reklamacionin dhe t'i përgjigjet reklamacionit të parashtruar:

- në afat prej 30 ditësh për dërgesa postare në komunikacionin postar të brendshëm dhe
- në afat prej dy muajsh për dërgesa postare në komunikacionin postar ndërkombëtar.

(7) Në rast kur shfrytëzuesi i shërbimeve postare nuk do të marrë përgjigje për reklamacionin nga dhënësi i shërbimeve postare, nuk i është dhënë mundësi të parashtrorin reklamacion ose është i pakënaqur nga përgjigjja për reklamacionin, ka të drejtë të parashtrorin kërkesë për ngritjen e procedurës, në pajtim me dispozitat nga kreu XII i këtij ligji të Agjencia, në afat prej 15 ditësh pas kalimit të afatit nga paragrafi (6) i këtij neni.

Neni 64

Lartësia e kompensimit për dëmin e shkaktuar

(1) Dhënësi i shërbimeve postare obligohet që shfrytëzuesit të shërbimeve postare t'i paguajë kompensim për dëmin e shkaktuar, si vijon:

- a) për humbjen ose dëmtimin e plotë të:
 - dërgesës postare me vlerë të shënuar, në lartësi të vlerës të saj të shënuar dhe
 - dërgesës postare dhe pakos me rekomandim, 15 herë nga shumata e paguar për shërbimin;
- b) për dëmtim të pjesshëm të dërgesës postare ose vjedhjen e dërgesës:
 - për dërgesën postare me vlerë të shënuar, në lartësi të dëmit të saj real të shkaktuar, por jo më të madh se vlera e shënuar dhe
 - për dërgesë postare me rekomandim dhe pako, dhjetë herë nga shumata e paguar për shërbimin dhe
- v) për tejkalimin e afatit për dorëzim të:
 - dërgesave postare me prioritet, paguhet dhjetë herë nga shumata e paguar për shërbimin dhe
 - dërgesave postare joprioritare paguhet pesë herë nga shumata e paguar për shërbimin.

(2) Në rastet nga paragrafi (1), pika a) të këtij neni, dhënësi i shërbimeve postare krahas kompensimit obligohet që ta kthejë edhe shumën e paguar për shërbimin, të zvogëluar për shumën e paguar për manipulim të rekomanduar ose manipulim për dërgesë me vlerë të shënuar.

(3) Nëse krahas tejkalimit të afatit për dorëzim të dërgesave postare me rekomandim, dërgesës me vlerë të shënuar dhe pakos, ndodh edhe dëmtim i pjesshëm ose vjedhje e dërgesës, nga dhënësi i shërbimeve postare nuk mund të paguhet kompensim më i madh se vlera e shënuar në dërgesën postare.

(4) Lartësia e kompensimeve për dërgesa postare në komunikacionin ndërkombëtar postar, është e përcaktuar në pajtim me aktet ndërkombëtare të cilët i ka lidhur, përkatësisht i ka pranuar Republika e Maqedonisë.

(5) Dhënësi i shërbimeve postare nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar tërthorazi të dërgesave postare.

XII. ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 65

Zgjidhja e kontesteve me marrëveshje

(1) Agjencia mban procedurë për zgjidhje me marrëveshje të kontestit në raste të pacaktuara me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji ndërmjet dhënësit të shërbimit universal dhe dhënësit të shërbimeve postare, në lidhje me qasjen e rrjetit postar, si dhe ndërmjet dhënësit të shërbimeve postare dhe shfrytëzuesve të shërbimeve postare.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia fillon procedurë për zgjidhje me marrëveshje të kontestit në kërkesë të njëres nga palët në kontest ose në raste kur palët me shkrim janë marrë vesh që kontestin ndërmjet veti të zgjidhet me marrëveshje me procedurë në Agjenci.

(3) Zgjidhja me marrëveshje e marrëdhënieve kontestimore ndërmjet palëve, nga paragrafi 2 të këtij neni është procedurë vullnetare, efikase dhe e lirë, e cila mbahet në Agjenci në të cilën palët insistojnë që marrëdhënien kontestuese ta zgjidhin në mënyrë të qetë me ndihmën e Agjencisë, e cila me neutralitet dhe paanshmëri palëve u ndihmon të arrijnë zgjidhje të përbashkët të pranueshme.

(4) Procedurën për zgjidhje me marrëveshje të kontestit, palët vullnetarisht e ngritin, marrin pjesë në të njëjtën dhe në çdo kohë mund të heqin dorë nga e njëjta.

(5) Procedura për zgjidhje me marrëveshje të kontestit mbaron në afat prej 42 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, për fillimin e procedurës për zgjidhjen e kontestit, pa marrë parasysh rezultatin e saj.

(6) Afati përfundimtar për zgjidhjen e kontestit nga paragrafi (5) të këtij neni mund të vazhdohet nëse kjo është e nevojshme për shkak të vëllimit të procedurës, por nuk guxon të jetë më i gjatë se katër muaj. Pajtimin për vazhdim të tillë, palët e shprehin me shkrim.

(7) Agjencia obligohet që në procedurën për zgjidhjen me marrëveshje të kontestit, t'i ketë parasysh edhe qëllimet për sigurimin e konkurrencës efikase dhe mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve të tregut, në pajtim me këtë ligj.

(8) Kur kjo është e përcaktuar me ligj dhe kur do të konstatojë ose kuptojë se në pikëpamje të gjendjes së përhershme faktike duhet për shkak të mbrojtjes së interesit publike të ngritet procedurë administrative, Agjencia do të ngritë procedurë me detyrë zyrtare, me ç'rast do t'i marrë parasysh edhe të dhënat nga kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni.

(9) Procedura administrative me detyrë zyrtare nga paragrafi (8) të këtij neni, ngritet dhe udhëhiqet në pajtim me Ligjin për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(10) Agjencia i shpall në ueb faqen e saj marrëveshjet e arritura ndërmjet palëve, përkatësisht vendimet në procedurën për zgjidhje me marrëveshje të kontesteve, me ç'rast mban llogari për zbatimin e rregullave për mbrojtje dhe qasje të të dhënave personale dhe informatave të klasifikuara.

(11) Agjencia e përcakton mënyrën e veprimit gjatë zgjidhjes së kontesteve.

Neni 66

Arbitrazhi

Dhënësi i shërbimit universal dhe dhënësit e shërbimeve postare si shfrytëzues të rrjetit postar, si dhe dhënësit e shërbimeve postare dhe shfrytëzuesit e shërbimeve postare mund të merren vesh me shkrim, që kontesti të zgjidhet me arbitrazh në mënyrë dhe procedurë të përcaktuar me këtë ligj.

Neni 67

Procedura e arbitrazhit

(1) Procedurën e arbitrazhit e zbaton Këshilli i Arbitrazhit i cili zgjidhet nga lista e arbitrave.

(2) Procedura e arbitrazhit fillon me dorëzimin e propozimit me shkrim në Agjenci nga njëra ose të dyja palët në kontest, e cila ia kalon Këshillit të Arbitrazhit.

Neni 68

Lista e arbitrave

(1) Lista e arbitrave përbëhet prej së paku dhjetë personash kompetentë dhe profesionalë nga sfera e shërbimeve postare, shkencave teknike, drejtësisë, ekonomisë dhe sfera tjera që janë me rëndësi për realizimin e kompetencave të Agjencisë dhe i njëjti mbahet në Agjenci.

(2) Arbitrat emërohen nga Komisioni, organi i administratës shtetërore kompetent për kryerjen e punëve nga sfera e shërbimeve postare dhe palët tjera të interesuara.

(3) Mandati i arbitrit, është pesë vjet me mundësi për emërim të sërishëm.

(4) Arbitrat e emëruar duhet të jenë të paanshëm dhe të pavarur nga palët në procedurë.

Neni 69

Themelimi i këshillave të arbitrazhit

(1) Këshillat e arbitrazhit themelohen në mënyrën në vijim:

- çdo palë në kontest, në afat prej shtatë ditësh nga dita e parashtrimit të propozimit për procedurë të arbitrazhit, zgjedh nga një arbitër nga lista e arbitrave dhe

- të dy arbitrat e zgjedhur nga palët në kontest, në afat prej shtatë ditësh nga zgjedhja e tyre duhet me përgjegjësi të zgjedhin arbitër të tretë nga lista e arbitrave, i cili do të jetë kryesues i Këshillit të Arbitrazhit.

(2) Nëse zgjedhja e kryesuesit, ose e cilitdo arbitër tjetër nuk është kryer në afatin e përcaktuar në paragrafin (1) të këtij neni, drejtori i Agjencisë obligohet që ta bëjë zgjedhjen e këtyre personave në afat prej pesë ditësh pas kalimit të afatit të përcaktuar.

(3) Afati për zgjedhjen e arbitrave mund të vazhdohet me marrëveshje ndërmjet palëve në kontest dhe për atë duhet ta njoftojë Agjencinë.

Neni 70 Rregulla të procedurës

(1) Palët në kontest me marrëveshje mund t'i zgjedhin rregullat e procedurës për Këshillin e Arbitrazhit.

(2) Në mungesë të marrëveshjes së tillë, Këshilli i Arbitrazhit në mënyrë të pavarur vendos për mënyrën e mbajtjes së procedurës.

(3) Këshilli i Arbitrazhit i dëgjon palët, i shqyrton ankesat dhe vërejtjet dhe palëve u jep propozime për zgjidhje me marrëveshje të kontestit.

(4) Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje me marrëveshje e kontestit, Këshilli i Arbitrazhit e zgjedh kontestin sipas bindjes personale.

(5) Vendimi i arbitrazhit mund të jetë i kapshëm për publikun, por vetë dosja për procedurën e arbitrazhit mbetet e fshehtë.

Neni 71 Vendi dhe shpenzimet e arbitrazhit

(1) Nëse ndryshe nuk është marrë vesh me palët në kontest, Këshilli i Arbitrazhit e zgjedh vendin e procedurës së arbitrazhit.

(2) Shpenzimet për arbitrazhin i bartin në mënyrë të barabartë palët në kontest, përveç nëse nuk merren vesh ndryshe.

Neni 72 Vendimi i arbitrazhit

(1) Arbitrazhet mbarojnë me miratimin e vendimi nga ana e Këshillit të Arbitrazhit.

(2) Arbitrat i miratojnë vendimet me shumicë votash.

(3) Vendimi i arbitrazhit u dorëzohet palëve në kontest dhe deponohet te Agjencia.

(4) Vendimi i arbitrazhit, duke i përfshirë edhe konkluzionet e përcaktuara në lidhje me faktet ose çështjet ligjore, janë të detyrueshme për palët në kontest dhe zbatohen nëpërmjet të gjykatave.

(5) Kundër vendimit të Këshillit të Arbitrazhit, nuk lejohet ankesë.

XIII. MBIKËQYRJA

Neni 73 Kompetenca për kryerjen e mbikëqyrjes

(1) Mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, kryen Agjencia.

(2) Mbikëqyrjen nga paragrafi (1) të këtij neni, e kryejnë persona udhëheqës dhe profesionalë nga Agjencia, të autorizuar për këtë me aktvendim të drejtorit të Agjencisë (në tekstin e mëtejme: personi i autorizuar).

(3) Drejtori i Agjencisë miraton program vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes dhe parashtron raport vjetor për mbikëqyrje të kryer si pjesë përbërëse të raportit vjetor për punën për vitin paraprak të Agjencisë për Posta.

Neni 74 Obligimet e personit të autorizuar

Personi i autorizuar kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji, rregullave dhe akteve tjera të përgjithshme të miratuara në bazë të tij, e veçanërisht mbi:

- qasjen në shërbimin universal,
- kualitetin e sigurimit të shërbimit universal,
- sigurimin e qasjes në rrjetin postar,
- zbatimin e çmimeve të shërbimit universal,
- implementimin e të gjitha akteve të lëshuara nga Agjencia dhe
- punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe rregullat dhe aktet tjera të përgjithshme të miratuara në bazë të tij.

Neni 75 Personi i autorizuar

(1) Për person të autorizuar mund të emërohet personi i cili është i punësuar në Agjenci dhe i cili ka arsim të lartë në fushën e komunikacionit postar, drejtësisë, ekonomisë dhe shkencave teknike, me së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

(2) Drejtori i Agjencisë personit të autorizuar i lëshon legjitimacion zyrtar që i shërben për vërtetimin e cilësisë së tij zyrtare dhe i cili obligohet që ta tregojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(3) Formën dhe përmbajtjen e legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (2) të këtij neni dhe mënyrën e lëshimit dhe heqjes, i përcakton Agjencia. Legjitimacioni zyrtar personit të autorizuar i hiqet kur i është hequr autorizimi ose i ka pushuar marrëdhëniet e punës në Agjenci.

(4) Personi i autorizuar ka të drejtë dhe detyrë që në mënyrë profesionale të aftësohet për kryerjen e punëve dhe detyrave të veta në pajtim me programin për trajnim të specializuar, të miratuar nga drejtori i Agjencisë.

(5) Personi i autorizuar ka të drejtë për shumë të rritur të rrogës në lartësi prej 10% deri në 30%. E drejta për shumë të rritur të rrogës përcaktohet me aktet e përgjithshme për punën e Agjencisë në varësi nga marrëveshja, lloji dhe shkalla e ekspozimit në rreze gjatë kryerjes së punëve të mbikëqyrjes.

Neni 76 Procedura për mbikëqyrje

(1) Mbikëqyrja mund të jetë:

1) mbikëqyrje e rregullt e cila përfshin mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, në bazë të programit vjetor për kryerje të mbikëqyrjes,

2) mbikëqyrja e jashtëzakonshme e cila sipas rregullës bëhet pa paralajmërim, në bazë të iniciativës së parashtruar nga shfrytëzues ose dhënëse të shërbimeve postare si dhe në rast dyshimi të personit të autorizuar (me detyrë zyrtare) dhe

3) mbikëqyrje kontrolluese e cila kryhet pas kalimit të afatit të përcaktuar në aktvendimin e miratuar nga ana e drejtorit të Agjencisë, me ç'rast personi i autorizuar gjatë përcaktimit të gjendjes faktike do të konstatojë se subjekti i mbikëqyrjes:

- ka vepruar sipas aktvendimit në tërësi,
- ka vepruar sipas aktvendimit në mënyrë të pjesshme ose
- nuk ka vepruar sipas aktvendimit.

(2) Për mbikëqyrjen e kryer personi i autorizuar përpilon procesverbal të cilin ia jep subjektit të mbikëqyrjes për nënshkrim.

(3) Procesverbali duhet të përmbajë pasqyrë të gjendjes së përcaktuar faktike mbi mbikëqyrjen.

(4) Formën dhe elementet e detyrueshme nga procesverbali për mbikëqyrjen e kryer, i përcakton Agjencia.

(5) Për rezultatet nga mbikëqyrja personi i autorizuar obligohet që menjëherë e më së voni në afat prej tri ditësh nga kryerja e mbikëqyrjes ta njoftojë drejtorin e Agjencisë dhe t'i parashtrorë draft të aktvendimit së bashku me të gjitha shkresat nga mbikëqyrja. Draftin e aktvendimit e përcakton personi i autorizuar.

(6) Në rast të kundërvajtjes së përcaktuar gjatë mbikëqyrjes, personi i autorizuar obligohet që menjëherë ta njoftojë drejtorin e Agjencisë dhe t'ia dorëzojë të gjitha shkresat nga mbikëqyrja për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

(7) Procedurën për mbikëqyrje personi i autorizuar e zbaton në pajtim me dispozitat nga ky ligj dhe ligj tjetër.

Neni 77

Të drejtat dhe obligimet e subjektit të mbikëqyrjes

(1) Subjekti i mbikëqyrjes obligohet që personit të autorizuar gjatë kryerje së mbikëqyrjes t'i mundësojë kryerje të papenguar të mbikëqyrjes.

(2) Për kryerje të papenguar të mbikëqyrjes përgjigjet subjekti i mbikëqyrjes dhe personi përgjegjës në subjektin e mbikëqyrjes.

(3) Subjekti i mbikëqyrjes obligohet që personit të autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes t'i mundësojë:

- hyrje në lokal dhe mjet transportues ku gjenden mjetet dhe lëndët për sigurimin e shërbimeve postare dhe dërgesave dhe

- t'i paraqesë për inspektim dhe me kërkesë të personit të autorizuar t'ia japë të gjitha informatat e nevojshme, të dhënat dhe dokumentacionin pa marrë parasysh mediumin në të cilin të njëjtat ruhen.

(4) Nëse personi i autorizuar dyshon se ndonjë person juridik ose fizik i cili nuk ka parashtruar notifikacione të Agjencia siguron shërbime postare, personi juridik ose fizik obligohet që personit të autorizuar për kryerje të mbikëqyrjes t'i sigurojë:

- hyrje në lokal dhe mjet transportues ku gjenden mjetet dhe lëndët për sigurimin e shërbimeve postare dhe dërgesave dhe

- t'i paraqesë për inspektim dhe me kërkesë të personit të autorizuar t'ia japë të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm pa marrë parasysh mediumin në të cilin të njëjtat ruhen.

(5) Nëse personit të autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes nuk i mundësohet hyrje në lokalin banesor, personi i autorizuar mundet këtë ta bëjë me urdhëresë të lëshuar nga gjykata kompetente.

(6) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë të japë deklarata në procesverbal dhe vërejtje lidhur me mbikëqyrjen me arsyetim për shkaqet e të njëjtave.

(7) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë që të refuzojë ta nënshkruajë procesverbalin, nëse nuk pajtohet me faktet të cilat janë theksuar në procesverbal ose i është pamundësuar e drejta nga paragrafi (6) i këtij neni. Refuzimi të nënshkruhet procesverbalin nuk e pengon kryerjen e mëtejme të mbikëqyrjes.

(8) Agjencia e përcakton mënyrën e kryerjes së mbikëqyrjes.

Neni 78

Aktivendimi

(1) Në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji ose rregullës tjetër të miratuar në bazë të këtij ligji të përcaktuar nga ana e personit të autorizuar dhe të konstatuar me procesverbal, drejtori i Agjencisë miraton aktivendim.

(2) Me aktivendimin nga paragrafi (1) të këtij neni, përcaktohen kushtet dhe urdhërohen detyrime, masa dhe aktivitete të cilat dhënësi i shërbimeve postare obligohet t'i plotësojë dhe kryejë, për mënjanimin e parregullsive të konstatuara, në afate të caktuara në mënyrë përkatëse me natyrën dhe rëndësinë e kushteve dhe detyrimeve.

(3) Dhënësi i shërbimeve postare obligohet që të veprojë sipas aktivendimit nga paragrafi (1) të këtij neni dhe t'i mënjanojë parregullsitë e konstatuara në afatin e caktuar.

Neni 79

E drejta për mbrojtje gjyqësore

(1) Aktivendimi i drejtorit të Agjencisë i miratuar në procedurë administrative është i plotfuqishëm.

(2) Kundër aktivendimit nga paragrafi (1) të këtij neni, mund të parashtrohet padë për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës kompetente.

(3) Padia për ngritjen e kontestit administrativ parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktivendimit dhe e njëjta nuk e shtyn zbatimin e aktivendimit.

XIV. DISPOZITA KUNDËRVAJTËSE

Neni 80

(1) Gjohë në shumë prej 3 500 deri në 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personi juridik-dhënësi i shërbimeve postare, nëse:

- nuk siguron shërbim universal në pajtim me nenin 30 paragrafi (2) të këtij ligji,

- me sigurimin e shërbimit universal në nëntë muaj të njëpasnjëshëm ose 12 muaj gjatë dy viteve nuk e arrin kualitetin e përcaktuar nga neni 31 paragrafi (2) të këtij ligji,

- një herë në vit nuk dorëzon të dhëna të marra nga matja e kualitetit të sigurimit të shërbimit universal në komunikacionin postar të brendshëm dhe ndërkombëtar (neni 31 paragrafi (6)),

- siguron shërbime postare pa autorizim të përgjithshëm në kundërshtim me nenin 38 paragrafi (2) të këtij ligji,

- siguron shërbime postare të cilat nuk janë të theksuara në autorizimin e përgjithshëm (neni 41 paragrafi (2)),

- siguron dërgesa për korrespondencë dhe shërbime të postës së drejtpërdrejtë me çmime më të ulëta nga kufizimi i përcaktuar (neni 41 paragrafët (3), (4) dhe (5)),

- bartë të drejta dhe detyrime të personi tjetër i autorizuar (neni 43),

- siguron shërbime postare edhe pas shfuqizimit të lejes individuale dhe autorizimit të përgjithshëm (neni 46 paragrafi (5)),

- siguron shërbime postare edhe pas heqjes së lejes individuale ose autorizimit të përgjithshëm (neni 45 paragrafi (7)),

- nuk ndërton, nuk e mirëmban dhe nuk e zhvillon rrjetin postar (neni 47 paragrafi (1)),

- nuk mundëson qasje të rrjetit postar në pajtim me nenin 47 paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk dorëzon ofertë për qasje për miratim (neni 47 paragrafi (3)),

- nuk vepron në kushte të grevës, në pajtim me nenin 49 të këtij ligji,

- aplikon çmime të cilët nuk janë të lejuara nga Agjencia (neni 50),

- nuk mban kontabilitet të veçantë në pajtim me nenin 51 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji,

- bën subvencionim të shërbimeve tjera në kundërshtim me nenin 51 paragrafi (4) të këtij ligji,

- emeton pulla postare në kundërshtim me nenin 52 të këtij ligji,

- dorëzon dërgesë postare në kundërshtim me paragrafin (1) të nenit 54 të këtij ligji,

- nuk e ruan fshehtësinë e dërgesave postare gjatë sigurimit të shërbimeve postare nga neni 58 të këtij ligji,

- siguron dërgesa postare me përmbajtje të ndaluar (neni 60 të këtij ligji),

- nuk mundëson hyrje të personit të autorizuar në pajtim me nenin 77 paragrafët (3) alineja 1 dhe (4) alineja 1 të këtij ligji,

- nuk i paraqet për inspektim dhe me kërkesë të personit të autorizuar nuk i jep të gjitha informatat, të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm në pajtim me nenin 77 paragrafët (3) alineja 2 dhe (4) alineja 2 të këtij ligji dhe

- nuk vepron sipas aktvendimit dhe nuk i mënjanon parregullsitë e konstatuara në afatin e përcaktuar (neni 78 paragrafi (3)).

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 2 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni, personit juridik, krahas gjobës mund t'i shqiptohet edhe ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë së caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muajsh deri në tre vjet.

(4) Për kundërvajtjet nga paragrafi (2) të këtij neni personit përgjegjës të personit juridik, krahas gjobës mund t'i shqiptohet edhe ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet.

Neni 81

(1) Gjobë në shumë prej 1 500 deri në 2 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik-dhënës i shërbimeve postare, nëse:

- nuk ia jep në disponim informatat dhe të dhënat financiare Agjencisë për kryerjen e kompetencave të saj (neni 25 paragrafi (1)),

- nuk dorëzon të dhëna për të hyrat e përgjithshme (neni 35 paragrafi (1)),

- mbyll njësi postare pa pëlqim të marrë (neni 36 paragrafi (6)),

- nuk lidh marrëveshje për qasje me dhënës të shërbimeve postare (neni 47 paragrafi 9)),

- gjatë përcaktimit të çmimi dhe kushteve për qasje te rrjeti postar bën dallim ndërmjet dhënësve të ndryshëm të shërbimeve postare (neni 47 paragrafi (14)),

- nuk parashikon çmime dhe kushte të përgjithshme nga neni 48 paragrafi (2) i këtij ligji,

- formon çmime për shfrytëzuesit e mëdhenj në kundërshtim me nenin 50 paragrafi (9) të këtij ligji,

- shfrytëzon pulla të pavlefshme postare në kundërshtim me nenin 53 paragrafi (1) të këtij ligji dhe

- e pengon kryerjen e mbikëqyrjes së personit të autorizuar (neni 77 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik, për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 82

(1) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik-dhënës i shërbimeve postare, nëse:

- nuk vendos sëndukë postarë (neni 56 paragrafi (1)),

- nuk i mirëmban sëndukët postarë në pajtim me nenin 56 paragrafi (2) të këtij ligji dhe

- nuk pranon ose nuk përgjigjet për reklamacionet e shfrytëzuesve të shërbimeve postare në pajtim me nenin 63 paragrafi (6) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 100 deri në 300 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 83

(1) Gjobë në shumë prej 500 deri në 1 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik-dhënës i shërbimeve postare, nëse:

- nuk i jep në disponim informata dhe të dhëna financiare Agjencisë kryerje të kompetencave të saj (neni 25 paragrafi (1)),

- nuk dorëzon të dhëna për të hyrat e përgjithshme (neni 35 paragrafi (1)),

- siguron shërbime postare pa autorizim të përgjithshëm (neni 38 paragrafi (2)),

- siguron shërbime postare të cilat nuk janë të theksuara në autorizimin e përgjithshëm (neni 41 paragrafi (2)),

- siguron dërgesa për korrespondencë dhe shërbime të postës së drejtpërdrejtë me çmime më të ulëta nga kufizimi i përcaktuar (neni 41 paragrafët (3), (4) dhe (5)),

- bartë të drejta dhe detyrime të personi tjetër i autorizuar (neni 43),

- siguron shërbime postare edhe pas anulimit të autorizimit të përgjithshëm (neni 45 paragrafi (7)),

- siguron shërbime postare edhe pas pushimit të vlefshmërisë së autorizimit të përgjithshëm (neni 46 paragrafi (5)),

- nuk parashikon çmime dhe kushte të përgjithshme nga neni 48 nga paragrafi (2) të këtij ligji,

- nuk mban kontabilitet të veçantë në pajtim me nenin 51 paragrafi (1) të këtij ligji,

- dorëzon dërgesë postare në kundërshtim me nenin 54 paragrafi (1) të këtij ligji,

- nuk e mbron fshehtësinë e dërgesave postare gjatë sigurimit të shërbimeve postare nga neni 58 të këtij ligji,

- kryen bartje të dërgesave postare bartja e të cilave është e ndaluar (neni 60)),

- nuk pranon dhe nuk përgjigjet për reklamacionet e shfrytëzuesve të shërbimeve postare në pajtim me nenin 63 paragrafi (6) të këtij ligji,

- e pengon kryerjen e mbikëqyrjes së personit të autorizuar në pajtim me nenin 77 paragrafi (1) të këtij ligji,

- nuk mundëson hyrje të personit të autorizuar në pajtim me nenin 77 paragrafët (3) alineja 1 dhe (4) alineja 1 të këtij ligji,

- nuk paraqet për inspektim dhe me kërkesë të personit të autorizuar nuk i jep të gjitha informatat, të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm në pajtim me nenin 77 paragrafët (3) alineja 2 dhe (4) alineja 2 të këtij ligji dhe

- nuk vepron sipas aktvendimit dhe nuk i mënjanon parregullsitë e konstatuara, në afatin e përcaktuar (neni 78 paragrafi (3)).

(2) Për kundërvajtjet nga paragrafi (1) të këtij neni, personit përgjegjës krahas gjobës mund t'i shqiptohet edhe ndalim i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej një deri në tre vjet.

Neni 84

Gjobë në shumë prej 300 deri në 500 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik-dhënës i shërbimeve postare, nëse:

- nuk pranon dhe nuk përgjigjet për reklamacionet nga shfrytëzuesit e shërbimeve postare në pajtim me nenin 63 paragrafi (6) të këtij ligji.

Neni 85

Procedura për edukim

(1) Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes personi i autorizuar konstaton se është kryer parregullsi nga nenet 82 dhe 84 të këtij ligji, është i detyruar që të përpilojë procesverbal në të cilin do ta përcaktojë parregullsinë e kryer me sugjerim për mënjanimin e parregullsisë së përcaktuar në afat të caktuar dhe me dorëzim të njëkohshëm të ftesës për realizimin e edukimit të personit ose subjektit ku është përcaktuar parregullsia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Formën dhe përmbajtjen e ftesës për edukim si dhe mënyrën e realizimit të edukimit e përcakton Komisioni i Agjencisë.

(3) Edukimin e organizon dhe realizon personi i autorizuar, në afat jo më të gjatë se tetë ditë nga dita e kryerjes së mbikëqyrjes.

(4) Edukimi mund të realizohet për më shumë parregullsi të përcaktuara të njëjta ose të njëllotja, për një ose më shumë persona.

(5) Nëse në afatin e caktuar personi për të cilin realizohet edukimi nuk paraqitet në edukim, do të konsiderohet se edukimi është realizuar.

(6) Nëse personi për të cilin realizohet edukimi paraqitet në edukimin e caktuar dhe e kryen atë, do të konsiderohet se është edukuar në lidhje me parregullsinë e përcaktuar.

(7) Nëse personi i autorizuar gjatë kryerjes së mbikëqyrjes kontrolluese konstaton se janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara nga paragrafi 1 i këtij neni, me konkluzion ndërpritet procedura për mbikëqyrje, e nëse konstaton se nuk janë mënjanuar parregullsitë e përcaktuara, personi i autorizuar është i detyruar që menjëherë ta njoftojë drejtorin e Agjencisë dhe t'ia dorëzojë të gjitha shkresat nga mbikëqyrja për ngritjen e procedurës kundërvajtëse.

(8) Agjencia mban evidencë për edukimin e realizuar në mënyrë të përcaktuar nga Komisioni i Agjencisë.

Neni 86

Procedura për barazim

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara me këtë ligj para parashtrimit të kërkesës për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, personi i autorizuar obligohet që kryerësit të kundërvajtjes t'i parashtrorë procedurë për barazim.

(2) Kur personi i autorizuar do të konstatojë kundërvajtje nga paragrafi (1) të këtij neni, përpilon procesverbal në të cilin shënohen elementet e rëndësishme të kundërvajtjes, koha, vendi dhe mënyra e kryerjes së kundërvajtjes, përkrahimi i veprimit të kundërvajtjes dhe personat e gjendur në vendin e ngjarjes. Procesverbalin e nënshkruajnë personi i autorizuar dhe kryerësi.

(3) Nëse kryerësi e pranon kundërvajtjen personi i autorizuar i jep urdhërpagesë për arkëtimin e gjobës për kundërvajtje.

(4) Me nënshkrimin e urdhërpagesës konsiderohet se kryerësi i kundërvajtjes pajtohet që ta paguajë gjobën e shqiptuar.

(5) Kryerësi i kundërvajtjes nga paragrafi (1) i këtij neni, obligohet që ta paguajë gjobën në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të urdhërpagesës në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë, të shënuar në urdhërpagesë. Kryerësi i cili do ta paguajë gjobën në afatin e përcaktuar në këtë paragraf, do ta paguajë vetëm gjysmën e gjobës së shqiptuar.

(6) Nëse kryerësi i kundërvajtjes refuzon që ta nënshkruajë urdhërpagesën personi i autorizuar evidenton se personi refuzon të nënshkruhet.

(7) Nëse kryerësi i kundërvajtjes nuk pajtohet për procedurë për barazim ose në afatin e përcaktuar nuk e paguan gjobën, personi i autorizuar obligohet që ta njoftojë drejtorin e Agjencisë dhe t'ia dorëzojë të gjitha shkresat nga mbikëqyrja për ngritje të procedurës kundërvajtëse.

(8) Agjencia mban evidencë për procedurat kundërvajtëse për barazim.

XV. DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 87

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të vazhdojnë në Agjenci, në pajtim me Ligjin për shërbime postare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2008).

Neni 88

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit si organe të Agjencisë dhe drejtori i Agjencisë, të emëruar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, e vazhdojnë punën deri në mbarim të mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 89

Statuti i Agjencisë do të harmonizohet me dispozitat e këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 90

(1) Dhënësi ekzistues i shërbimit universal pas hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojë ta sigurojë shërbimin universal së bashku me shërbimin e rezervuar në bazë të lejes individuale, të lëshuar nga Agjencia në pajtim me Ligjin për shërbime postare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", numër 9/2008) deri në skadimin e afatit të vlefshmërisë së lejes.

(2) Personat juridikë dhe fizikë të cilët kanë marrë leje individuale dhe standarde ose leje për sigurimin e shërbimeve postare, do të vazhdojnë me sigurimin e tyre në mënyrë dhe në kushte të përcaktuara në këtë ligj.

(3) Për zbatimin e këtij ligji, Agjencia mund të kërkojë nga personat nga paragrafi (2) i këtij neni të dhëna plotësuese, nëse konsideron se është e nevojshme.

Neni 91

(1) Aktet nënligjore miratimi i të cilave është paraparë me këtë ligj, do të miratohen në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji. (2) Deri në miratimin e rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të zbatohen rregullat ekzistuese.

Neni 92

(1) Dhënësi i shërbimit universal me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ka të drejtë ekskluzive që të sigurojë shërbime të rezervuara postare deri më 31 dhjetor 2014.

(2) Pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni, shfuqizohen dispozitat nga neni 41 paragrafët (3), (4) dhe (5), neni 80 paragrafi (1) alineja 6 dhe neni 83 paragrafi (1) alineja 5 të këtij ligji.

Neni 93

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për shërbime postare ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 9/2008).

Neni 94

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

3306.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

УКАЗ

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА ФИНАНСИСКИТЕ ДРУШТВА

Се прогласува Законот за финансиските друштва, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 6 декември 2010 година.

Бр. 07-4951/1
6 декември 2010 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Горге Иванов, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.